



PËRRALLËZA
PËR FËMIJËT
E MENÇUR

-1-



HARUN JAHJA

Të dashur fëmijë! Në këtë libër me përralla, që është shkruar posaçërisht për ju, ka mjaft fakte të rëndësishme. Në të, ju do të gjeni shumë shembuj të mrekullive tek gjallesat e krijuara nga Allahu dhe do të shihni edhe një herë natyrën unike të fuqisë së Zotit tonë. Ju, gjithashtu, do të kujtoheni t'i përgjigjeni me durim dhe nënshtrim çdo ngjarjeje të krijuar nga Allahu dhe ta falënderoni Atë në çdo moment.

Në të do të mësoni pse është e rëndësishme të silleni mirë me njerëzit që ju rrethojnë, se pastërtia është cilësi e besimtarit, se fjalët e këndshme janë virtyt që e kënaqin Allahun.

Ja tek janë titujt e disa prej përrallave në këtë libër:

Amari dhe Breshka; Çfarë i mësoi Rashidit vëllai? Omeri dhe Pinguini; Xhemali dhe Papagalli; Në Gjithçka Ka Mirësi; Është e Rëndësishme të Ndjekësh Fjalën e Mirë; Naimi dhe Palloi i Bukur; Enveri dhe Zogu i vogël; Aliu dhe Shoku i tij i vogël; Maksudi dhe Kotelja; Sejidi dhe Kalamari; Qerimi dhe gjysh Hasani

Dy fjalë rreth autorit



I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare.

Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Allah dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Librat e Harun Jahja u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si ekzistenca e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ta.



**Shtëpia Botuese "Furkan ISM"
Brigada II Maqedonase, lokali 22
1000 Shkup, Maqedoni**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



**Përrallëza për
fëmijët
e mençur
-1-**

HARUN JAHJA



Dy fjalë rreth jetës së autorit

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Harun Jahja është njohur mirw si autor i veprave të rëndësishme të cilat zbulojnë mashtrimin e evolucionistëve, pohimet e tyre të pavërteta dhe lidhjet e errëta midis Darwinizmit dhe ideologjive gjakësore, të tilla si: fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahja, të përkthyer në 57 gjuhë të ndryshme, përbëjnë një koleksion prej më se 45,000 faqesh me 30,000 ilustrime.

Pseudonimi i tij është një kompozim i emrave të Harunit (Aaron) dhe Yahya (John), në kujtim të dy Profetëve të nderuar, të cilët luftuan kundër mohimit të besimit. Vula e Profetit në librat e tij është një simbol i cili është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ky simbol paraqet Kur'anin (Shpalljen e Fundit) dhe Profetin Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), Profetin e fundit. Nën dritën e udhëzimit të Kur'anit dhe Sunnetit (traditës dhe mësimëve të Profetit), autori i ve vetes si qëllim të hedhë poshtë çdo ngrehinë të ideologjive që mohojnë fenë dhe të thotë "fjalën e fundit" në mënyrë që të bëjë të heshtë çdo kundërshtim i ngritur kundër fesë. Ai e përdor vulën e Profetit të fundit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të), i cili arriti urtësinë më të lartë dhe përsosmërinë morale, si një shenjë të qëllimit të tij për të ofruar fjalën e fundit.

Të gjitha veprat e Harun Jahja kanë një qëllim të përbashkët: të japin mesazhin e Kur'anit, të inkurajojnë lexuesit për të menduar mbi çështje që kanë të bëjnë me besimin, si për shembull, ekzistenca e Allahut dhe njëshmëria e Tij dhe besimi në Botën Tjetër dhe njëkohësisht të nxjerrë në pah rrënjët e kalbura të sistemeve antifetare dhe ideologjive të devijuara.

Harun Jahja gëzon një rang të gjerë lexuesish në shumë vende të botës, që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, Poloni, e deri në Bosnjë, Spanjë, Brazil, Malaizi, Itali, Francë, Bullgari, e deri në Rusi. Disa nga librat e tij mund të gjenden në gjuhën Angleze, Frënge, Gjermane, Spanjolle, Italiane, Portugeze, Urdu, Arabe, Shqipe, Kineze, Dhivehi (folur në ishujt Mauritius) Ruse, Serbo-Croate (Boshnjake), Polake, Malaje, Turke



Uygur, Indoneziane, Bengali, Daneze dhe Suedeze.

Duke qënë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Allah dhe për të arritur një depërtim më të thellë në besimin e tyre. Mençuria dhe sinqeriteti që i karakterizon librat e tij, së bashku me një stil të veçantë që është i lehtë për t'u kuptuar, ndikon drejtpërdrejt çdokënd që i lexon. Ata që i studiojnë me kujdes këta libra, nuk mund të mbrojnë më ateizmin apo ndonjë ideologji tjetër të devijuar apo filozofi materialiste, sepse këta libra karakterizohen nga një efektshmëri e shpejtë, përfundime të qarta dhe janë të pakundërshtueshëm. Edhe nëse këta njerëz do të vazhdojnë të këmbëngulin në të tyren, nuk do të jetë gjë tjetër veçse një këmbëngulje sentimentale, sepse këto libra përmbysin ideologji të tilla që nga themelet. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore antifetare tashmë mbrohen ideologjikisht, falë librave të shkruar nga Harun Yahya.

Kjo është pa dyshim një rezultat i urtësisë dhe dritës së Kur'anit. Autori në mënyrë modeste dëshiron të shërbejë si një mjet në kërkimin njerëzor të rrugës së drejtë të Allahut. Prej botimit të këtyre materialeve nuk kërkohet asnjë përfitim material.

Ata njerëz që inkurajojnë të tjerët për të lexuar këto libra, për të hapur mendjet dhe zemrat e tyre dhe për t'i udhëzuar ata të bëhen robër të devotshëm të Allahut, kryejnë një shërbim të paçmuar.

Njëkohësisht do të ishte një humbje kohe dhe energjie për të propaganduar libra të tjerë, të cilët krijojnë konfuzion në mendjet e njerëzve, i shpien ata në kaos ideologjik dhe që nuk kanë një ndikim të fortë dhe preciz në largimin e dyshimit prej mendjeve të njerëzve, siç është vërtetuar nga përvoja e përparshme. Për librat që janë shkruar vetëm e vetëm për të nxjerrë në pah fuqinë letrare të shkrimtarit se sa qëllimin fisnik për t'i shpëtuar njerëzit nga mungesa e besimit është e pamundur që të kenë një ndikim kaq të madh. Ata që e venë në dyshim këtë mund të shohin qartë se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahja është të mposhtë mohimin dhe njëkohësisht të përhapë vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi manifestohen qartë në bindjen e lexuesve.

Një gjë duhet të mbahet parasysh: Arsyeja kryesore për vazhdimin e mizorisë, konflikteve dhe telasheve të tjera që po përjetojnë shumica e njerëzve sot është mbizotërimi ideologjik i mohimit. Kësaj mund t'i jepet fund vetëm me mposhtjen ideologjike të mohimit dhe njëkohësisht duke transmetuar mrekullitë e krijimit dhe moralin e Kur'anit në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke patur parasysh gjendjen e botës sot, që po precipiton në një spirale dhune, korrupsioni dhe lufte, është e qartë se ky shërbim duhet të jepet shpejt dhe në mënyrë të efektshme, përndryshe, do të jetë tepër vonë.

Në këtë përpjekje, librat e Harun Jahja marrin një rol udhëheqës. Me lejen e Allahut, këto libra do të jenë një mjet nëpërmjet të cilit njerëzit në shekullin e XXI do të gjejnë paqen, drejtësinë, dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Të dashur fëmijë

- Në këtë libër i është kushtuar një kapitull i veçantë rënies së teorisë së evolucionit, sepse kjo teori është baza e të gjitha filozofive materialiste. Darwinizmi mohon krejtësisht faktet e krijimit dhe ekzistencën e Allahut dhe, si rrjedhim, përgjatë 140 viteve të fundit shumë njerëz kanë braktisur besimin e tyre, duke rënë pre e dyshimit. Për këtë arsye, është një detyrë e rëndësishme që t'i tregoni çdo njeriu se kjo teori s'është gjë tjetër veçse mashtrim. Meqenëse, jo të gjithë lexuesit mund të lexojnë disa nga librat tanë, ne e kemi menduar të arsyeshme që t'i kushtojmë një kapitull të veçantë të përmbledhur mbi këtë çështje.
- Të gjithë librat e Harun Jahjas, nën dritën e vargjeve kuranore, shpjegojnë tema që kanë lidhje me besimin dhe i ftojnë lexuesit të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë në përputhje me to. Të gjitha çështjet në lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë që të mos lihet vend për dyshim apo për pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i thjeshtë dhe i rrjedhshëm i librave mundëson që çdo njeri, i çfarëdo moshe qoftë dhe i çfarëdo grupi social, t'i kuptojë ata me lehtësi. Falë shpalosjes së tyre të efektshme dhe të ndritshme, ata mund të lexohen me një frymë. Madje, edhe ata njerëz, që e refuzojnë besimin, ndikohen nga faktet që dokumentojnë këta libra dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.
- Ky libër, si të gjithë librat e Harun Jahjas mund të lexohet individualisht ose të diskutohet në grup. Lexuesit e etur, për të përfituar nga librat e tij, do të zbulojnë se diskutimi është mjaft i dobishëm dhe u mundëson atyre të shkëmbejnë reflektimet dhe përvojën e tyre me të tjerët.
- Një shërbim i madh për Islamit do të ishte kontributi në botimin dhe leximin e këtyre librave, shkruar vetëm për hir të Allahut. Të gjithë librat e Harun Jahjas janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, për t'ia komunikuar të tjerëve fenë e vërtetë, një nga mënyrat më të efektshme do të ishte nxitja për leximin e tyre.
- Shpresojmë se lexuesi do t'i hedhë një sy përmbledhjeve të librave të tjerë të autorit, të cilat janë vendosur në pjesën e pasme të këtij libri. Lënda e tij e pasur në çështjet e besimit është mjaft e dobishme dhe të sjell kënaqësi në lexim.
- Në këta libra, ndryshe nga librat e tjerë, janë mënjeluar tërësisht pikëpamjet personale të autorit, shpjegimet e bazuara në burime të dyshimta, stile që nuk i kushtojnë kujdesin e duhur temave fetare dhe as argumente të pashpresë apo pesimistë, të cilët krijojnë dyshime në mendjen e lexuesit dhe devijime në zemrat e tyre.

HARUN TAHJA

**Përrallëza për
fëmijët
e mençur**

-1-



Shtëpia Botuese "Furkan ISM"
Brigada II Maqedonase, lokali 22
1000 Shkup, Maqedoni



PËRMBAJTJA

<i>Amari dhe Breshka</i>	10
<i>Husejni dhe Elefanti</i>	14
<i>Çfarë i Mësoi Rashidit Vëllai?</i>	16
<i>Omeri dhe Pinguini</i>	20
<i>Xhemali dhe Papaqalli</i>	22
<i>Në Gjithçka Ka Mirësi</i>	24
<i>Ahmedi dhe Rosa</i>	28
<i>Ketrat e Lezetshëm Bishtqajatë</i>	34
<i>Është e Rëndësishme Të Ndjekësh</i>	
<i>Fjalën e Mirë</i>	40



<i>Pastërtia e Besimtarëve</i>	44
<i>Naimi dhe Palloi i Bukur</i>	48
<i>Enveri dhe Zoqu i Vogël</i>	50
<i>Aliu dhe Shoku i Tij i Vogël</i>	56
<i>Maksudi dhe Kotelja</i>	62
<i>Sejidi dhe Kallamari</i>	66
<i>Qemali dhe Kali i Detit</i>	70
<i>Qerimi dhe gjysh Hasani</i>	72
<i>Gjysh Uthmani dhe Nipi i Tij</i>	86
<i>Klasa Jonë</i>	88
<i>Shtojcë: Mashtrimi i Evolucionit</i>	94





AMARI dhe BRESHKA

Një ditë Amari po lexonte një nga tregimet e tij të dashura, “Lepuri dhe Breshka”. Teksa lexonte ai qeshte me atë që i ndodhi lepurshit të gjorë. Ndërsa nga breshka, ai mësoi se sa e rëndësishme është që njeriu të verë në punë mendjen dhe se zgjuarsia vlen më tepër se një garë për të treguar se kush është më i forti. Kur po mendonte këto, papritur e kuptoi se breshka e librit ishte bërë e gjallë dhe filloi t’i fliste: -“Hej, përshëndetje Amar! Sa mirë që ti je kaq i ri dhe i mençur sa të nxjerrësh një mësim nga përralla për mua dhe lepurin.”

I çuditur, Amari e pyeti: - “Po ti sa vjet je?”


Breshka u përgjigj: -“Hm, unë nuk jam aq e re sa dukem, unë jam 45 vjeç. Ne breshkat jetojmë afërsisht 60 vjet. Madje ka një lloj breshke e quajtur Testudo, e cila rron deri në 189 vjet.”

-“Cilën stinë të vitit do ti më shumë?” - e pyeti Amari.

-Breshka u përgjigj: “Moti i ngrohtë është shumë i rëndësishëm për mbijetesën tonë. Temperatura e trupit tonë ndryshon sipas temperaturës së ajrit dhe është zakonisht midis 32.2° – 32.4° Fahrenait (0.1 - 0.2 gradë Celcius) më e ulët se ajo e ajrit. Sistemi ynë tretës gjallërohet me ngritjen e temperaturës. Kur na krijoi Allahu, na i dha këtë cilësi të dobishme që na i lehtëson mbijetesën në mot të nxehtë. Ne kemi nevojë për të gjitha dhuratat që na jep Ai, por Ai është i Pasuri që nuk ka nevojë për asgjë.”

Amari e dëgjonte i habitur. Pastaj ai e pyeti: -“Po ty, cili ushqim të pëlqen më shumë?”





***Çdo gjë që është në qiej
dhe në tokë i takon
Allahut. Ai është i Pasuri
që s'ka nevojë për
askënd, i Lavdëruari.
(Haxh:64)***


-“Ne breshkat vdesim për kungull të verdhë. Sytë tanë janë mjaft të mprehtë dhe e shohin ngjyrën e verdhë më mirë nga të tjerat. Kjo do të thotë se ne mund ta gjejmë lehtë ushqimin tonë të preferuar.”
- u përgjigj breshka.

Amarit i lindi një pyetje tjetër. Ai ishte shumë kurioz dhe i tha:- “Po ju, a flini në dimër?”

-“Po”,- tha breshka, - kur ftohet moti, që nga tetori e në vazhdim, ushqimi gjendet me shumë vështirësi, ne bëhemi shumë të ngathëta dhe kështu e mbrojmë veten duke shkuar për të fjetur, jo pak, po, për disa muaj rresht. Në këtë kohë, rrahjet e zemrës ulen, po ashtu edhe frymëmarrja ngadalësohet. Ne flemë që nga tetori deee...ri në mars. Ne nuk kemi përse të rrimë zgjuar në dimër, duke mos pasur asgjë për të ngrënë; kjo do të ishte e pamundur për ne. Prandaj, Allahu na krijoi në këtë mënyrë. Kështu na mbron gjithmonë Allahu, duke na vënë në gjumë tamam në kohën e duhur.”

Tashmë, Amari, i cili ishte bërë edhe më tepër kurioz, e pyeti: -“Unë e di se ju jetoni në tokë të thatë, por kam mësuar se disa nga ju jetojnë në ujë, apo jo? Mund të më tregosh diçka për to?”





Breshka buzëqeshi dhe tha: -"Ke të drejtë Amar. Ne jemi disa llojesh: breshka toke, breshka lumi dhe breshka që jetojnë në det. Unë për shembull, jetoj në tokë të thatë. Më pëlqejnë fushat, toka e butë dhe hardhitë. Ndërsa, breshkave të ujit të ëmbël, ato që ju i mbani në akvarium, u pëlqejnë më shumë liqenet dhe brigjet e lumenjve. Breshkat e detit rrojnë në detet e ngrohta dhe kur u vjen koha për të lëshuar vezët dalin në tokë. Më lejo të të tregoj diçka tepër interesante për breshkat e detit të quajtura Kareta.

Kareta karetas dalin në brigjet e ngrohta për të lëshuar vezët. Është pikërisht Allahu, që i drejton breshkëzat e vogla, të cilat, sapo dalin nga vezët, drejtohen drejt vendit ku do të jetojnë përgjithmonë, në det, në sajë të dritës së vezulluar nga valët e detit. Po si e dinë këto breshkëza të vogla se deti është vendi më i mirë për të jetuar? Zoti ynë i frymëzon ato që ta kuptojnë këtë."

Amari iu përgjigj:- "Ke të drejtë. Çdo njeri që ka mend duhet ta dijë se bota është e mbushur me mrekullitë e krijimit të Allahut. Ne gjithmonë duhet të sjellim ndër mend se ti dhe unë, të gjithë kafshët dhe bimët dhe çdo gjë tjetër, janë shenja të Tij. Unë u kënaqa shumë që fola me ty. Faleminderit që më tregove gjithë këto gjëra interesante. Mirupafshim, breshkë e vogël!"

- "Mirupafshim, o djalë i zgjuar!" - tha breshka dhe u largua.





Lejlekët këmbëgjatë

Lejlekët janë zogj të mëdhenj shtegtarë, rreth 1-1,5 metra të gjatë, me krahë të mëdhenj, të bardhë. Sqepat e tyre të kuq dhe këmbët e holla i bëjnë të duken të lezetshëm. Për çdo vit ata emigrojnë në tufa të mëdha, sepse nuk mund të jetojnë në vende të ftohta. Lejlekët janë ata që na tregojnë se ditët e ngrohta të verës po afrohen. Kjo është një mrekulli. Si e dinë ata se kur bëhet gati të ngrohet moti? Vitin tjetër, kur vjen vera përsëri, ata kthehen nga udhëtimi i tyre prej qindra kilometrash dhe i gjejnë foletë e vjetra. Sigurisht, është Allahu që i ka krijuar një kujtesë kaq të mirë dhe ndjenjën e mbajtjes së drejtimit në udhëtim.



HUSEJNI DHE ELEFANTI

Në fundjavë, nëna e çoi Husejnin në kopshtin zoologjik. Ishte hera e parë që ai shihte kaq shumë kafshë të ndryshme së bashku në një vend. Shkuan tek shtëpia e elefantit. Atje, një elefant i vogël pengohej mbi feçkën e tij dhe rrëzohej. Nëna e tij e ndihmonte të ngrihej sa herë që binte.

Nëna e elefantit e pa Husejnin që po i shikonte me vëmendje dhe i shpjegoi: "A e sheh, është shumë i vogël dhe ende nuk di ta përdorë feçkën. Ai nuk do të largohet prej meje për 12 vitet që do të vijmë dhe mua më duhen plot 6 muaj për t'i mësuar si ta përdorë feçkën."

Husejni u përgjigj:- "Unë gjithmonë kam qenë kurioz të di, përse i përdorin elefantët feçkat? Merrni frymë me to?"

Nëna elefantit i filloi t'i shpjegonte:- "Feçkat tona na bëjnë të ndryshëm nga të gjithë kafshët. Vrimat me të cilat marrim ajër ndodhen në fund të feçkës dhe ne i përdorim ato për të sjellë ushqim dhe ujë në gojë, për të ngritur sende dhe për të nuhatur. Me feçkat tona mund të mbajmë deri në 4 litra ujë. A e di ti se ne mund të mbajmë edhe një bizele të vogël në to? Mësoje se nuk i kemi fituar rastësisht këto gjëra. Ato janë dhuratë nga Allahu i Plotfuqishëm, i cili krijoi gjithçka."

Pasi dëgjoi nënën elefant, Husejni vazhdoi ta pyesë:- "Po si ia bëni për të gjetur ushqim të mjaftueshëm?"

Nëna elefantit iu përgjigj:- "Ne jemi kafshët më të mëdha që jetojnë mbi tokë. Një elefant ha rreth 330 kilogram bimë në ditë. Neve na duhet të kalojmë 16 orë në ditë duke ngrënë."

Husejni kurioz bëri gati një pyetje tjetër:- "Po dhëmbët? Më trego diçka për to."



Nëna elefant vazhdoi të fliste: -"Siç mund ta shohësh, unë kam dy dhëmbë të gjatë dhe të mprehtë. Ne mbrohem me ta, gjithashtu i përdorim për të hapur gropa, për të gjetur ujë. Sigurisht që, duke bërë gjithë këto punë, dhëmbët tanë prishen dhe, për këtë arsye, Allahu i Plotfuqishëm na ka dhënë një aftësi të veçantë. Sa herë që prishet dhëmbi, del një tjetër, i ri, në vend të tij."

Husejni mendoi për një moment:- "Ti tani duhet të jesh e uritur, po të gërhasin zorrët."

Nëna elefant buzëqeshi dhe tha: -"Jo, kjo zhurmë nuk tregon që jam e uritur. Ne elefantët i lëshojmë këta tinguj për të komunikuar me njëri-tjetrin. A e di se ne mund të flasim me njëri-tjetrin deri në 4 km largësi?"

Husejni u habit dhe ia ktheu: -"Po si flisni me njëri-tjetrin?"

Nëna elefant i tha: -"Allahu na ka krijuar në ballë një organ të veçantë që lëshon tinguj që njerëzit nuk mund t'i dëgjojnë. Kështu, ne flasim me anë të një kodi, të cilin edhe kafshët e tjera nuk e kuptojnë dhe e dëgjojnë njëri-tjetrin nga distanca shumë të largëta. Siç mund ta shohësh, krijimi i mrekullueshëm i Allahut mund të vërehet mirë tek ne, elefantët, por mos harro, se ne duhet të mendojmë mbi këto gjëra dhe, në të njëjtën kohë, ta falënderojmë Allahun vazhdimisht!"

Husejni pohoi me kokë dhe i tha: -"Faleminderit që më tregove gjithë këto gjëra interesante. Tani më duhet të shkoj se më pret mami."

-"Mirupafshim, Husejn!" -tha nëna elefant.

Rrugës për tek nëna e tij ai ecte dhe mendonte, "Kush e di sa të mrekullueshme janë krijimet e Allahut te kafshët e tjera!"





Çfarë i mësoi Rashidid vëllai



Një ditë, Rashidi po kthehej nga shkolla për në shtëpi dhe qëndroi tek stacioni i autobusit. Ndërsa po priste atje, i dëgjoi zërat e disa fëmijëve të tjerë, të cilët po bisedonin me njëri-tjetrin. Atij i ra në sy se njëri prej tyre fliste me zë të lartë dhe tregonte me gisht këmishën e tij dhe një makinë elektrike që mbante në dorë. Ai filloi ta dëgjonte bisedën me vëmendje.

Djali që po fliste me zë të lartë quhej Asim. Ai po i lëvdohej shokëve të tij për rrobat e tij të shtrenjta dhe lodrat më të fundit. Kur u kthye në shtëpi, Rashidit nuk po i dilte nga mendja ajo që dëgjoi. Zubejri, vëllai i tij, kur e pa se Rashidi kishte rënë në mendime, u ul pranë tij dhe e pyeti:

-“Çfarë ke Rashid? Përse po mendohesh?”

Rashidi u përgjigj: -“Kur po kthehesha për në shtëpi, pashë një djalë që u lëvdohej shokëve për rrobat e shtrenjta dhe lodrat e tij të bukura. Vërtet, ai nuk mendonte fare se çfarë flis-



te; nuk i binte ndër mend se shokët e tij mund të mos kishin mundësi t'i blinin ato. Mendoj se sjellja e tij ishte shumë e gabuar."

Zubejri pohoi me kokë dhe ia ktheu: -"Ke të drejtë, Rashid, mënyra se si foli ai djalë nuk ishte e mirë. Allahu na ka dhuruar mirësi të ndryshme. Fakti që një njeri ka më shumë pasuri, është më i pashëm apo më i suksesshëm, nuk varet vetëm nga aftësitë e tij. Allahu na i ka dhënë këto mirësi për të na provuar ne dhe për të parë se si do të sillemi ne pas dhurimit të tyre. Ai kënaqet shumë kur njeriu nuk harron për asnjë çast se është Allahu që i ka dhënë gjithçka që ai ka. Për këtë arsye, ne nuk duhet të mburremi apo të prishim sjelljen për shkak të mirësive që na ka dhuruar dhe duhet të jemi gjithmonë të thjeshtë. Sidoqoftë, shejtani fryhet dhe mburret me krenari. Nëse të kujtohet vargu që lexuam dje, fliste për këtë çështje. Allahu na mëson ne në Kuranin e Shenjtë: **"Mos u dëshpëroni tepër për atë që ka kaluar dhe as mos u gëzoni tepër me atë që u është dhënë, sepse Allahu nuk do asnjë arrogant që u lavdërohet të tjerëve."**" (Hadid: 23)

Rashidi pohoi me kokë dhe tha: -"Ne nuk duhet të prishemi për shkak të mirësive me të cilat na ka bekuar Allahu dhe nuk duhet të mërzitemi apo të dëshpërohemi kur humbim diçka. A kam të drejtë, Zubejr?"

Zubejri vuri buzën në gaz: -"Ke të drejtë! Allahu ka gjithçka. Ai na jep ato mirësi që dëshiron, qofshin të shumta apo të pakta, ato të gjitha janë pjesë e provës në këtë botë."



**Allahu ju nxori prej mitrave të
nënave tuaja si foshnjë që nuk
dinit asgjë dhe ju dha dëgjimin,
shikimin dhe zemrën, ndoshta ju
do t'i jeni mirënjohës.
(Nahl: 78)**

Më pas, Rashidi e pyeti të vëllanë: -"Në një varg Allahu thotë:
"Mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete, me të cilën i bëmë të kë-
naqen disa prej tyre, për t'i sprovuar me të, sepse shpërblimi i
Zotit tënd është më i mirë dhe i përjetshëm." (Ta Ha: 131)

Mënyra si u soll Asimi ishte e gabuar, por, a nuk u sollën
gabim edhe shokët e tij, të cilët u mahnitën nga ato që fliste? A
e kënaq kjo sjellje Allahun? Allahu na ka dhënë gjithçka, veshjet
tona, ushqimin, shtëpinë apo makinën dhe,
të sillemi kështu, vërtet, na bën të
nënçmojmë vetveten, apo jo?"

Zubejri u mendua për një çast dhe tha:
-"Sigurisht. Ti e shpjegove mirë, por, më
lë të të tregoj një histori nga
Kurani. Në të Allahu na jep shem-
bullin e dy njerëzve, njëri prej të
cilëve kishte dy kopshte dhe
Allahu bëri që ato të ngarko-
heshin me hurma dhe drithë. Kur
erdhi koha e vjeljes, të dy kopshtet e u
mbushën plot. Midis tyre kalonte një lumë që i
vadiste dhe ndihmonte prodhimin. Një ditë,



pronari i tyre i foli shokut të tij me përçmim dhe i tha: "Unë kam më shumë pasuri dhe më shumë shërbëtorë se ti."
(Kehf: 34)

Duke u mburrur me pasurinë që kishte ai shkante në kopshtin e tij dhe i tregonte shokut të tij: "... Unë nuk mendoj se kjo pasuri do të zhduket ndonjëherë. Nuk besoj se do të vijë Dita e Kiametit, por, nëse kthehem te Zoti im, pa dyshim që do të gjej të ardhme më të mirë se kjo." (Kehf: 35-36)

Shoku i tij e paralajmëroi duke i thënë: "-Pse ti kur hyre në kopshtin tënd nuk the: "Ma shae Allah, la haule ue la ku-ute il-la bil-lah"-Allahu çka do bëhet, s'ka fuqi pa ndihmën e Tij. Nëse ti më sheh mua se kam më pak fëmijë dhe pasuri se ti, mund të ndodhë që Zoti im të më japë diçka më të mirë se kopshti yt..." (Kehf: 39-40)

Pronari i kopshtit nuk ua vuri veshin këshillave të shokut dhe më në fund Allahu e dënoi duke dërguar një stuhi, e cila i shkatërroi të gjitha të mbjellat. Kur u ngrit në mëngjes, shkoi te kopshti dhe pa se kishte humbur gjithçka me të cilën krenohej. E kuptoi se Allahu ka fuqi të madhe dhe gjithçka është nën mbikëqyrjen e Tij. Ne nuk duhet ta harrojmë asnjëherë këtë histori, Rashid, dhe duhet të sillemi ashtu siç na mëson ajo."



Omari dhe pinguini



Një natë, para se të binte për të fjetur, Omari, bashkë me babain e tij, ndoqi një film dokumentar. Filmi fliste për kafshët dhe ai u habit shumë nga fakti se si arrijnë disa kafshë të mbijetojnë edhe në kushtet më të vështira të ambientit. Kur ra në shtrat, po mendonte për atë që kishte parë në televizor dhe nisi të imagjinonte që edhe ai jetonte atje, bashkë me kafshët. Papritur, e gjeti veten në një vend të mbuluar krejt me borë. Filloi të çapitej rreth e rrotull, kur, papritur e pakujtuar, dëgjoji një zë: -"Mirë se erdhe, Omar!"

- "Kush je ti?" - e pyeti ai.

- "Unë jam pinguini."

- u përgjigj kafshëza e vogël.

Krijesa që po i fliste dukej tamam sikur kishte veshur frak. Omarit i ra ndër mend menjëherë se kush ishte ai që po i fliste. Edhe dokumentari që kishte parë atë mbrëmje me babain kishte një pjesë që fliste për pinguinët.

- "Oh, po, tha Omari, unë sapo kam parë diçka për jetën tënde në televizor. Ëmmm..., është vërtet ngricë këtu. Po ti, nuk sëmuresh asnjëherë?"

Pinguini iu përgjigj: - "Këtu është Poli i Jugut dhe temperaturat mund të shkojnë deri në -88°C. Kjo klimë mund t'u shkaktonte vdek-

jen shumë kafshëve, por, ne nuk kemi asnjë vështirësi që jetojmë këtu, kjo, falë cilësive të veçanta që na ka dhuruar Allahu. Ne nuk na bën dëm moti i ftohtë, ashtu si kafshëve të tjera, sepse nën lëkurë kemi veshur një pallto të ngrohtë prej dhjami. Kur vjen dimri, përgjatë bregdetit, ne drejtohem për nga jugu.”

Omarit i ra ndër mend përse e kishte fjalën ai dhe i tha: -“Kjo do të thotë se ju migroni! Po çfarë cilësish të tjera ke ti? Për shembull, unë mësova nga dokumentari se ju kujdeseni tepër për vezët derisa të çelin të vegjlit. Më trego, të lutem!”

Pinguini buzëqeshi dhe filloi të flasë: -“Ndryshe nga kafshët e tjera, vezët nuk i ngroh femra, por mashkulli. E ne e bëjmë këtë në temperturën -30°C për 65 ditë pa lëvizur asnjë çast nga vendi. Në këtë kohë, nëna pinguin shkon larg për të kërkuar ushqim për zogjtë që do të çelin. Pasi çelin, zogjtë e kalojnë muajin e tyre të parë të jetës mbi këmbët e nënës dhe të babait, sepse, nëse do t'i lëshonin, qoftë edhe për dy minuta, ai do të ngrinte për vdekje.”

Omari tundi kokën i habitur: -“Kjo do të thotë se ju duhet të jeni vërtet shumë të kujdesshëm, apo jo?”

Pinguini iu përgjigj: -“Allahu i ka mësuar çdo kafshe se si të jetojë. Ne veprojmë ashtu siç na ka frymëzuar Ai.”

-“Po, ia ktheu Omari, Zoti ynë i ka mësuar çdo krijese kur dhe ku duhet të jetojë dhe si ta gjejë ushqimin. Jeta juaj, o miku im, është një shembull i mirë për këtë.”

Pinguini u kthye për të ikur dhe i tha: -“Ti mund të gjesh shumë shembuj edhe tek krijesat e tjera. Familja ime po më pret, duhet të shkoj tani.”

Papritur, Omari dëgjoji tringëllimën e një zileje që po binte. Tashmë ishte mëngjes dhe ora me zile po bënte detyrën e saj. E kuptoi se udhëtimi i tij s’kishte qenë gjë tjetër veçse një ëndërr e bukur.





XHEMALI DHE PAPAGALLI

Xhemali gjithmonë kishte ëndërruar të kishte një zog në shtëpi. Ai nuk mund t'i besonte syve atë ditë kur babai mbante në duar një kafaz të madh. Kur hapi kapakun dhe pa një papagall me ngjyrë të verdhë të ndezur dhe të purpurt, u gëzua pa masë. Atë mbrëmje, Xhemali dhe papagalli filluan të bisedonin si dy miq të vjetër.

Xhemali e përshëndeti dhe i tha: -"O papagall i bukur, unë dua të të ushqej mirë dhe të mësoj gjithçka për ty. Po, më parë, më thuaj cili ushqim të pëlqen më shumë?"

-"Ushqimi im i preferuar janë farat."

-"Po si i ha ato?" - e pyeti Xhemali.

-"Unë mund ta mbaj ushqimin me të dy këmbët dhe ta ha atë si një sanduiç. Jam ekspert për ta ndarë lëvozhgën e farës përgjysmë me gjuhë. Kjo është vërtet një bekim dhe mirësi nga Allahu."

Më pas, Xhemali e pyeti: -"Jam shumë kurioz të di, nga i ke gjetur ato ngjyra të mrekullueshme në pendët e tua?"

-"Si të gjithë zogjtë, ngjyrat e shumëllojshme krijohen nga një substancë që ndodhet brenda në pendë, kur ato fillojnë të formohen dhe kjo lidhet me mënyrën se si reflektohet drita në to. A e di ti se, kur më bien pendët, më zëvendësohen me të reja? Sa herë që ato rriten, kanë të njëjtën ngjyrë. Kjo është një provë tjetër e përsosmërisë së krijimit të Allahut."

Xhemali pohoi me kokë: -"Kjo është vërtet e mrekullueshme. Ti mund të imitosh tingujt që dëgjon. Po, më thuaj, si e bën këtë?"

**Ai është Allahu - Krijuesi,
Shpikësi, Formësuesi ...
(Hashr:24)**

-“Po, unë mund të imitoj tingujt që dëgjoj, por nuk mund t’i kuptoj ata. Edhe kjo ndodh me vullnetin e Allahut, përndryshe, si do të mundej një krijesë si unë, pa logjikë dhe vullnet, të zhvillonte aftësinë për të imituar tingujt? Vetëm Zoti ynë i Plotfuqishëm e ka fuqinë të shpikë një zog të tillë që flet dhe ka pendë shumëgjyreshe. Është Ai që i krijon gjërat në mënyrë të përsosur.”- i shpjegoi papagalli.

Xhemali buzëqeshi i kënaqur dhe ia ktheu: -“Teksa të vështroj më rritet admirimi për Allahun e Plotfuqishëm. Do të përpiqem që ti të ndihesh rahat këtu në shtëpinë tonë. Uroj t’ia kalojmë mirë bashkë, papagall i bukur!”

-“Mbaj mend, -i tha papagalli- se gjëja më e mirë që mund të bëjmë ne kur shohim përsosmërinë e krijimit të Allahut në univers është të përkujtojmë madhësitinë e Tij, ta falënderojmë dhe ta mbajmë në mendje gjithmonë.”



NË ÇDO GJË KA MIRËSI

Aliu është një nxënës i mirë. Ai vazhdon shkollën fillore. Mësu-
esi dhe shokët e duan shumë. Ai është gjithmonë i rregullt, e
respekton nënën dhe babain e tij dhe më të vjetrit. Por, Aliu mër-
zitet tej mase për gjërat që i ndodhin dhe shqetësohet për ato gjë-
ra nuk kanë ndodhur ende. Për shembull, kur pret që të ketë teste
në shkollë, ai ka frikë se mos marrë ndonjë notë të keqe dhe, ndo-
nëse, studion shumë për to, ai sëmuret nga shqetësimi. Kjo e bën
shpesh atë të papërqendruar dhe ndonjëherë ka dhënë edhe
përgjigje të gabuara për pyetje që ai i di shumë mirë. Kur ka diç-
ka që ai nuk e bën dot, ose gjërat nuk vijnë siç dëshiron, ai
mbushet me një dëshpërim të pashpresë. Inatoset me veten kur
mendon se përse nuk mundi të bënte diçka, ose përse diçka nuk
ndodhi ashtu siç dëshironte.

Një ditë, kur po kthehej nga shkolla, Aliu ishte shumë i gëzuar
dhe i emocionuar, si gjithnjë. Kur arriti në shtëpi, nëna po bënte
gati drekën në kuzhinë. Sapo e përshëndeti, ai filloi t'i tregonte si
ia kishte kaluar në shkollë.

-“Mami, -tha ai i entuziazmuar, -ne do të shkojmë piknik me
shkollën këtë fundjavë. Do të marrim me vete ushqime,
do të luajmë me top, do të shëtisim, do të këndojmë
këngë, do të luajmë. A nuk është e mrekullueshme?”

-“Po, Ali, më dhe një lajm shumë të mirë, -buzë-
qeshi nëna, - eja tani, laj duart dhe fillo të bësh dety-
rat.”





Bëri siç i tha e ëma. Lau duart dhe fytyrën dhe nisi të bënte detyrat, por ishte ende shumë i emocionuar. Po mendonte se sa shumë do të kënaqeshin në piknik. Papritur, një mendim i rrufeshëm ia përshkoi mendjen. -“Po sikur të sëmurem në fundjavë?! Atëherë nuk do të mundem të shkoj në piknik. Do të më duhet të qëndroj në shtëpi, ndërsa të gjithë shokët e mi do të kënaqen duke luajtur me top.” Menjëherë u mërziu tej mase. Gjithë gëzimi u tret. Ndërsa bënte detyrat, vazhdonte të mendonte.

Në mbrëmje, erdhi babai. Më pas, nëna i thirri për të ngrënë darkë. U ulën për të ngrënë. Aliu qëndronte i heshtur dhe i ngrysur për shkak të mendimeve të këqija që i vërtiteshin në mendje. E ëma u habit kur vuri re se ai kishte ndryshuar në fytyrë. Po ashtu, edhe babai e vuri re dhe filluan të bisedonin.

-“Çfarë bërë sot në shkollë?” - e pyeti babai.

-“Ne mësuam plot gjëra të reja, babi. - u përgjigj Aliu. Në matematikë u ngrita në dërrasë dhe zgjidha problemat që na dha mësuesi.”





-“A nuk do t’ia tregosh babit lajmin e mirë që more sot, Ali?” - e pyeti nëna.

-“Babi, ne do të shkojmë në piknik këtë fundjavë.”

-“Oh, ky është lajm i mirë, Ali, -buzëqeshi babai,- po, ti nuk dukesh shumë i gëzuar për këtë.”

Nëna e tij shtoi: -“Ti ishe me të vërtetë i gëzuar kur erdhe nga shkolla, por tani dukesh i mërzitur.”

-“Po, unë isha i gëzuar, por pastaj më erdhi një mendim që më mërziti.”

-“Pse je i mërzitur, Ali?” - e pyeti babai.

Ali filloi t’i tregonte shkakun e mërzisë: -“Po sikur të sëmurem në fundjavë dhe të mos shkoj në piknik? Do të mërzitem shumë.”

E ëma u përpoq ta qetësonte: -“Ali, ti nuk je i sëmurë tani dhe ne nuk mund ta dimë çfarë do të na ndodhë më vonë. A është e drejtë që ti të mërzitesh për diçka që nuk është e sigurt nëse ndodh apo jo?”

Babai shtoi: -“Dëgjo, Ali, ti je i mërzitur, sepse shejtani të ka futur këto mendime të këqija në mendje dhe je i shqetësuar për gjëra që nuk kanë





ndodhur ende. Ja ç' do të thotë të jesh i frikësuar! Të gjitha mendimet e këqija që na vijnë në mendje dhe të gjitha ankthet që ndiejmë në zemër janë shqetësime që na i shkakton shejtani. Allahu na tregon në Kuran çfarë duhet të bëjmë kur na pushtojnë këto shqetësime: "Nëse të godet shejtani me ndonjë vesves, kërko strehim tek Allahu. Ai është Dëgjuesi, Shikuesi." (A'raf: 200)

-"Ali, -shtoi nëna, -kur të vijnë këto mendime të këqija në mendje kthehu menjëherë tek Allahu dhe lutu."

Babai vazhdoi t'i shpjegonte: -"Allahu e ka përcaktuar që më parë gjithçka që do të ndodhë në jetën tonë. Ai dëshiron më të mirën për ne gjithmonë. Nëse nuk shkon në piknik, të jesh i sigurt se kjo është gjëja më e mirë për ty. Disa njerëz harrojnë se në çdo gjë që na ndodh ka mirësi dhe mërziten për diçka të pakëndshme që u ndodh. Por ata nuk e dinë se Allahu i ka mbrojtur me anë të saj nga diçka më e keqe. Ata nuk mendojnë në këtë mënyrë, prandaj janë gjithmonë në ankth dhe në dëshpërim."

Aliu tundi kokën në shenjë pohimi dhe tha: "Po, tani e kuptoj shumë mirë. Që prej këtij momenti, kur të më vijnë mendime të këqija në mendje, do t'i kthehem Allahut menjëherë dhe do ta falënderoj që më ka dhënë mirësi në çdo gjë."





Ahmedi dhe rosa e lumtur



Ahmedi, së bashku me familjen e tij, kishte shkuar për të vizituar gjyshin në fundjavë. Si zakonisht, para dreke, gjyshi e nxori shëtitje në park. Kur arritën atje, Ahmedi u gëzua shumë kur pa rosat që notonin në pellg. Gjyshi e dinte se atij i pëlqenin shumë rosat dhe kishte marrë me vete pak ushqim për to. Ia dha ushqimin dhe u ulën në një stol. Ahmedit nuk iu durua dhe vrapoi tek rosat.

-“Përshëndetje, mua më quajnë Ahmed. Ju kam sjellë pak ushqim.”

Njëra nga rosat foli dhe i tha: -“Përshëndetje, Ahmed, dhe falminderit.”





-“Unë po mendoja, tha ai, nëse nuk do t’ju ushqenin kujdestarët këtu, ose nëse do të jetonit në një vend pa njerëz, si do ta gjenit ushqimin?”

Rosa u përgjigj: -“Ne rosat, kur jetojmë në gjendje të lirë, nuk largohemi nga uji. Ne e sigurojmë ushqimin në ujë.”

-“Po unë nuk po shoh ndonjë ushqim atje ku po noton ti.”- tha Ahmedi i çuditur.

Rosa i shpjegoi: -“Ne e nxjerrim ushqimin nga uji në disa mënyra. Disa rosa qëndrojnë në sipërfaqe të ujit dhe hanë bimë dhe insekte. Të tjera e zhytin kokën dhe pjesën e sipërme të trupit nën ujë dhe kërkojnë ushqim me bishtin e ngritur lart. Ndërsa një grup tjetër, zhyten plotësisht nën ujë dhe e kërkojnë ushqimin gjithmonë ashtu.”

Ahmedit i lindi një pyetje tjetër: -“Po pse qëndroni në ujë gjithë kohën? Pse nuk ecni në tokë?”



-“Këmbët tona si lopata na i lehtësojnë shumë notin dhe ne mund të notojmë shumë shpejt, por e kemi të vështirë të ecim në tokë.” -iu përgjigj rosa.

Ahmedi e pyeti sërish: -“Kur unë hyj në ujë, më duhet të lëviz pa ndërprerë për ta mbajtur trupin në sipërfaqe. Ndonjëherë marr edhe komardaren që të mos fundosem. Po ju si qëndroni në sipërfaqe pa lëvizur?”

-“Ashtu sikur ti nuk ke pse të lëvizësh kur merr komardaren, edhe ajri që ndodhet brenda në trupin tonë na mban sipër ujit.” -iu përgjigj rosa.

Ahmedi ishte ende i hutuar dhe i tha: -“Kur unë marr komardaren nuk mund të zhytem nën ujë. Po ti si ia bën?”





-“Në trupat tanë ne kemi qese ajri që duken si balona të vogla.”- tha rosa. Kur mbushen ato me ajër, ne qëndrojmë mbi ujë dhe kur duam të zhytemi, ne e nxjerrim ajrin jashtë qeseve. Kështu mund të zhytemi më lehtë, sepse ka më pak ajër brenda në trup.”

-“Ti mund të qëndrosh mbi ujë, mund të zhytesh nën të dhe mund të notosh për mrekulli.”- tha Ahmedi.

Rosa vazhdoi t’i tregonte se si ajo notonte aq mirë: -“Ne mund të notojmë lehtësisht për shkak të këmbëve tona si lopata. Ne i lëvizim ato përpara dhe prapa në ujë. Rrjetat në këmbët tona hapen dhe na lejojnë të bëjmë përpara në ujë me më shumë forcë.”

-“Tamam si lopatat që veshin të rriturit në këmbë kur shkojnë në verë për not, që të notojnë më shpejt dhe më lehtë!”- brohoriti Ahmedi.

-“Po, ashtu është, Ahmed.”- pohoi rosa. -Nëse ti do t’i kishe këmbët si të miat, nuk do të mundeshe të ecje rehat në tokë. Sidoqoftë, ne jemi shpendë uji dhe forma e këmbëve tona na mundëson të notojmë dhe të ushqehemi lehtësisht.”





-“Të gjitha rosat duken njëloj, po çfarë ndryshimi ka midis tyre?” -u fut në mendime Ahmed.

-“Ne vërtet që ngjajmë njëloj, -tha rosa, -por ka mjaft ndryshime midis llojeve të ndryshme. Për shembull, rosakët kanë pendë më të ndritshme se sa rosat. Kjo është një mbrojtje shumë e rëndësishme për femrën, në kohën kur ajo ulet të ngrohë vezët. Armiqtë nuk mund ta dallojnë për shkak të ngjyrave të saj të zbehta dhe ajo është shumë e sigurt kur ngroh vezët. Ngjyrat e saj nuk ndryshojnë shumë nga toka dhe e bëjnë shumë të vështirë të shquhet edhe nga një distancë e afërt.”

-“Çfarë ndodh nëse afrohet një armik pranë folesë?” - pyeti Ahmed.

-“Në këtë rast, rosakët i tërheqin vëmendjen armikut nga femra në fole duke përdorur pendët e tyre të ndritshme. Kur i afrohet ndonjë armik folesë, rosakët menjëherë fluturojnë lart në ajër duke lëshuar shumë tinguj dhe duke u përperkur ta largojnë atë.”

Në atë çast, Ahmed pa disa rika që po notonin. Ai u habit që ato ishin aq të vogla dhe mund të notonin aq mirë dhe nuk nguroi ta pyesë rosën: -“Si mësojnë rikat e vogla të notojnë kaq shpejt?”





-“Vetëm disa orë pasi dalin nga vezët ato drejtohen drejt ujit dhe nisin të notojnë.”
-e sqaroi rosa.

Ahmedi po vriste mendjen ç’mund t’i kishte ndodhur atij nëse do ta kishin lënë në ujë disa orë pas lindjes. Ai sigurisht nuk do të ishte në gjendje të notonte, do të gëlltiste shumë ujë dhe do të vdiste. Ai po meditonte mbi faktin se si Allahu i ka krijuar kaq përsosmërisht rosat, në mënyrë që të jetojnë, të notojnë dhe të ushqehen në ujë. Gjyshi që e kishte vështruar deri atëherë, u ngrit nga stoli dhe iu afrua.

-“Gjysh, tha Ahmedi, -rosat notojnë shumë mirë, apo jo? Janë kaq të lezetshme!”

-“Po, Ahmed. Vetëm njëra nga cilësitë e tyre të veçanta do të mjaftonte për të na treguar se sa përsosmërisht e ka krijuar Allahu çdo gjallesë. A e di ti se rosat mund të fluturojnë? Kur fluturojnë, ato ndryshojnë gjithmonë drejtim me qëllim që të mos bien pre e armiqve.”

-“Po si e dinë rosat, o gjysh, që duhet të ndryshojnë drejtim gjithë kohën që t’i shmangen grabitqarëve?”- e pyeti Ahmedi.

Gjyshi i shpjegoi: -“Ashtu siç u ka dhënë kafshëve të tjera aftësi të veçanta, Allahu ia ka dhënë këtë aftësi edhe rosave, në mënyrë që të mbrohen. Allahu krijon çfarë të dëshirojë. Në Kuran është një varg që flet për këtë: “Allahu e





krijoi çdo gjallesë prej uji, e prej tyre ka që ecin rrëshqitas në bar-kun e vet, ka që ecin në të dy këmbët e të tjera që ecin në të ka-tër këmbët. Allahu krijon çfarë të dojë. Allahu ka fuqi mbi gjithçka.” (Nur: 45)

–“Eja, Ahmed, dreka është pothuaj gati. Tani është koha të kthe-hemi në shtëpi.”

–“Mirë, gjysh. Rrugës do të të tregoj çfarë mësova për rosat.”

–“Me të vërtetë?!” -e pyeti gjyshi. Po prej kujt i mësove ti gjithë këto gjëra?” Ahmedi ia shkeli syrin rosave në pellig dhe u tha mi-rupafshim me dorë.

Ia dha dorën gjyshit dhe u larguan. Rrugës bisedonin për kriji-min e përsosur të Allahut dhe e falënderonin Atë.



ROSAT

Rosat si çitahs, kur fluturojnë lëvizin po aq shpejt sa edhe një ma-kinë. Duke fluturuar ato vazhdimisht ndryshojnë drejtim me qëllim që të mos bien pre e grabitqarëve. Kur iu duhet të zhyten nën ujë, e bëj-në këtë aq shpejt sa gjuetarët e kanë të vështirë t'i qëllojnë.





Ketrat e Lezetshëm Bishtqjatë

Bilali dhe Daudi ishin dy shokë që shkonin shumë mirë me njëri-tjetrin. Ata sapo kishin mbaruar së lexuari një libër që bënte fjalë për jetën e kafshëve dhe ishin kënaqur shumë me të. Sa kënaqësi është të mësosh gjëra të reja dhe interesante për kafshët! Një mbrëmje ata folën me familjet e tyre dhe ua mbushën mendjen të shkonin një udhëtim në fshat në fundjavë. Rrugës ata i bënë pyetje njëri-tjetrit për kafshët që do të shikonin atje. Sapo dolën nga makina, filluan të vraponin të gëzuar midis pemëve. Prindërit e tyre u ulën nëpër stola dhe filluan të bisedonin. Bilali dhe Daudi u morën leje për të shëtitur përreth, pasi mezi prisnin të shihnin disa kafshë.

Pasi ecën pak, ndien një lëvizje nëpër gjethet e pemëve aty afër.

-“Daud, shiko atje!”- tha Bilali. Them se është ketër!”

-“Eja, tha Daudi, le ta shohim nga afër.”

Ishte vërtet një ketër që u foli: -“Ju dukeni djem shumë kuriozë. Unë e di se çfarë doni të dini.”





-“Hë, të lutem na trego!” -i tha Daudi.

-“Unë po mendohem pse ke një bisht aq të gjatë.” -tha Bilali.

Ketri filloi të fliste për t'i shuar kuriozitetin djemve:

-“Unë mund të ngjitem në shumë drejtime lart në pemë. Për shembull, unë mund të ngjitem në pemë shumë lehtë me kthetrat e mia të mprehta. Vrapoj nëpër degë, kolovitem me kokë poshtë, dhe madje eci po ashtu. Kushërinjtë e mi dhe unë quhemi “ketrat gri”. Ne mund të kërcejmë me lehtësi nga maja e një peme në tjetrën deri në 4 metra larg. Kërcejmë në ajër sikur të fluturonim, më pas i hapim krahët dhe këmbët dhe shkasim në ajër. Bishtin e drejtojmë për të mbajtur ekuilibrin dhe e përdorim atë si një timon që mban drejtimin.”

Daudi, pasi dëgjoi ketrin e pyeti sërish:

-“Kam lexuar në një libër se disa ketra fluturojnë. A kanë nevojë ata për diçka tjetër përveç bishtit të gjatë?”

-“Po.- u përgjigj ketri. Në Australi, ka disa lloje ketrash të cilët mund të fluturojnë. Ata janë nga 45 deri në 90 cm të gjatë. Ata zhvendosen nga një pemë në tjetrën me kërçime të gjata. Në vend të krahëve ata kanë një membra-





në rrëshqitëse dhe fluturojnë nga një pemë tek tjetra si avionë pa motor. Për shembull, membrana fluturuese e tyre shtrihet nga këmbët e parme deri në ato të pasme. Një ketër fluturues mund të kërcëjë nga trunghi i një peme me lëkurën e trupit të tij të tendosur dhe, ashtu si avion, ai është në gjendje të udhëtojë rreth 30 metra në një kërcim të vetëm. Ndonjëherë ata janë vënë re të fluturojnë në ajër në një distancë, jo pak, por 530 metra në 6 kërcime njëri pas tjetrit.”

-“Po si e llogaritin largësinë kur kërcëjnë midis pemësh që janë aq larg njëra nga tjetra?- pyeti me habi Bilali. -Atyre iu duhet të bëjnë llogaritje me qëllim që të ulen në vendin e caktuar. Vetëm një gabim i vogël do të mjaftonte për të rënë në tokë.”

-“Po, -tha ketri, -është shumë e vërtetë. Kur kërcëjmë, ne synojmë të arrijmë degët e holla dhe na duhet të kërcëjmë me kujdes për t’u ndalur në vendin e duhur. Për ta arritur këtë, ne përdorim këmbët tona të pasme, sytë tanë të mprehtë, të cilët janë shumë të saktë për të shquar largësinë, kthetrat tona të forta dhe bishtin, i cili na ndihmon të mbajmë ekuilibrin. Ai që na ka dhënë ne këto aftësi dhe që na ka udhëzuar si t’i përdorim është Zoti ynë i Plotfuqishëm. Përndryshe, për ne do të ishte e pamundur të përdorim metër për të matur lartësinë e pemëve dhe distancat ndërmjet degëve të tyre.”

Daudi, i cili ishte zhytur i tëri në këtë di-





turi interesante, e pyeti: -
"Përse e përdorni tjetër bishtin?"

Ndërsa Bilali shtoi:

-"Unë kam parë njëherë një film dokumentar, i cili tregonte se, kafshët e vogla e humbin temperaturën e trupit kur nuk lëvizin. Në mot të ftohtë, jeta e tyre vihet në rrezik nga ngrica, veçanërisht kur ata janë në gjumë. Si me të gjitha llojet e kafshëve, edhe me edhe me ju ketrat, Allahu ka krijuar mbrojtje në kushte të vështira. Ketrat kanë bishta të trashë dhe me push, të cilët i mbështjellin rreth vetes dhe flenë të mbledhur tamam si një top. Ky bisht i trashë është si një pallto dimri që i mbron ata nga ngrirja gjatë gjumit, kur moti është i ftohtë."

-"Po.- pohoi ketri. Bishti na mban ngrohtë kur temperatura është e ulët. Por bishtin ne e përdorim edhe për diçka tjetër. Ashtu si kafshët e tjera, edhe ne ketrat kemi mënyra të ndryshme komunikimi me njëri-tjetrin. Për shembull, ketrat e kuq, kur vërejnë një armik, tundin bishtin dhe lëshojnë disa tinguj ngacmues."

Daudi tregoi me gisht: -"Sa lajthi paske mbledhur! Duhet të jesh mjaft i uritur."

-"Në dimër ne e kemi të vështirë të gjejmë ushqim, kështu që përgatitemi që në verë duke e mbledhur atë. Ne jemi shumë të kuj-



desshëm kur grumbullojmë ushqimin. Nuk mund të ruajmë fruta, sepse ato prishen shpejt. Që të mos mbetemi të uritur në dimër, ne mbledhim vetëm lajthi, stika pische dhe ushqime të tjera që rrojmë. A e kupton? Unë do t'i ruaj këto lajthi për t'i ngrënë në dimër."

Daudi shtoi: -"Është Allahu Ai që ia mëson çdo krijese si të gjejë dhe si të depozitojë ushqimin; është Ai që ia jep çdo gjallesë ushqimin e përditshëm. Njëri nga emrat e bukur të Tij është "Furnizuesi", sepse Ai e ushqen çdo gjë të gjallë që ka krijuar. Kurani na tregon se sa i mëshirshëm dhe i dhembshur është Allahu: "Sa e sa gjallesa janë që nuk kanë mundësi për furnizimin e vet. Allahu i furnizon ata, edhe juve. Ai është Dëgjuesi, Shikuesi." (Ankebut: 60)

Ketri vazhdoi të fliste: -"Allahu i ka dhënë çdo krijese cilësi, të cilat e ndihmojnë atë për t'ju përshtatur ambientit ku ajo jeton. Për ne ketrat nuk është e mjaftueshme vetëm të gjejmë ushqim dhe ta ruajmë atë; kur vjen dimri, ne na duhet të gjejmë edhe vendin ku e kemi ruajtur ushqimin. Ne e bëjmë këtë në sajë të shqisës së mrekullueshme të të nuhaturit që na ka dhënë Allahu. Ne jemi në gjendje të nuhasim lajthitë e mbuluara nga një shtresë 30 cm nën dëborë.

Ushqimin që mbledhim e ruajmë në vende të ndryshme. Por më vonë, harrojmë ku e kemi vendosur. Por Allahu na bën të harrojmë me një qëllim të caktuar. Gjatë kësaj kohe, farat që kemi ruajtur nën tokë do të mbijnë dhe prej tyre do të dalin pemë të reja."

Bilali që kishte rënë në men



dime e pyeti i habitur: -"Lajthitë dhe gështenjat kanë lëvozhga mjaft të forta. Ne përdorim arrëthyese për t'i çarë. Po ju ketrat mund t'i çani ato pa arrëthyese?"

-"Ne kemi dhëmbë që janë më të mprehtë dhe më të fortë se dhëmbët e njeriut. -i shpjegoi ketri. Dhëmbët tanë të përparmë, të quajtur dhëmbë prerës, na lejojnë të presim materiale të forta, prapa tyre gjenden dhëmbët bluajtës. Falë dhëmbëve tanë të mprehtë ne mund të thyejmë lëvozhgën e çfarëdolloj lajthie, sado e fortë qoftë."

-"Po, a nuk u dëmtohen dhëmbët?" -desh të dinte Daudi.

-"Këtu, gjithashtu, ju mund të shihni harmoninë e përsosur që është vendosur në çdo gjë në mjeshtërinë e lartë krijuese të Zotit tonë. Nëse na prishen apo na thyhen dhëmbët, na dalin të tjerë në vend të tyre. Allahu ia ka dhënë këtë aftësi të gjitha krijesave që e shpojnë dhe e përtypin ushqimin." - i shpjegoi ketri.

Bilali shtoi: -"Kurani na tregon për bukurinë dhe përsosmërinë e gjallesave që ka krijuar Allahu: "Në krijimin tuaj dhe në krijimin e të gjitha gjallesave që Ai ka shpërndarë ka shenja për njerëzit që janë të bindur." (Xhathije: 4)

Daudi pohoi duke thënë: -"Ne duhet të sjellim gjithmonë ndër mend se Allahu e ka nën kontroll çdo gjallesë në çdo moment. Ne duhet ta falënderojmë Atë për të gjitha mirësitë që na ka dhënë, të lutemi që të bëhemi robërit e Tij të dashur dhe përherë t'i kërkojmë falje."

-"Po, ke të drejtë." - tha Bilali.

-"Na u bë vonë, Daud. Tani është më mirë të kthehemi. Ne të falënderojmë për të gjitha ato gjëra të bukura që na mësove, o ketër i bukur."

-"Mirupafshim, mirupafshim, miqtë e mi të vegjël." - ua bëri me dorë ketri dhe u largua.



ËSHTË E RËNDËSISHME TË NDJEKIM FJALËN E MIRË



Enesi ishte një djalë i mirë, i sjellshëm dhe punëtor. Babait të tij iu desh që të linte qytetin e tij dhe të banonte në një qytet tjetër. Enesit i erdhi shumë keq kur u nda nga shokët e vjetër.

Pak ditë, pasi ata u vendosën në apartamentin e ri, erdhën fqinjët për vizitë. Enesi u gëzua shumë, sepse atje kishte disa fëmijë moshatarë me të. I pëlqyen shumë shokët e rinj dhe me kalimin e ditëve u bënë shokë të ngushtë. Por, në atë grup, ishte një djalë me emrin Irfan, i cili gjithmonë ua ndërpriste lojën, sepse donte që ata të luanin atë lojë që ai dëshironte dhe, nëse nuk i bindeshin, ai zemërohej me ta.

Një ditë, ndërsa të gjithë djemtë po luanin në kopsht, erdhi Irfani. Ata po luanin me një lodër të re të Enesit. Ardhja e tij i shqetësoi të gjithë, sepse djemtë e dinin se sa herë që ai luante me ta, gjithmonë do të grindeshin. Këtë herë djemtë nuk e lejuan të luante me ta. Irfani u nxeh shumë; e mori lodrën e re të Enesit dhe e përplasi në tokë. Enesi u mërzit mjaft dhe bashkë me shokët e tij filluan të grindeshin me Irfanin. Gjysh Afsari dëgjoji zërat e djemve dhe vështroi nga dritarja. Ai i donte shumë ata, interesohej për ta dhe shpesh flisnin bashkë për Allahun, për mirësitë që na jep Ai dhe për adhurimin që na ka bërë detyrim. Kur e pa se djemtë po grindeshin, menjëherë zbriti poshtë dhe iu afrua. Irfani po qante. Ata i treguan si ishte puna dhe më pas u ulën të gjithë në kopsht për të biseduar.

Enesi i shpjegoi çfarë kishte ndodhur: -"Gjysh Afsar, shokët e mi dhe unë shkojmë gjithmonë mirë dhe luajmë pa u grindur, por Irfani gjithmonë na i prish gëzimin dhe ne nuk duam të jemi më shokë me të."

-"Po ata nuk bëjnë ashtu si them unë." - u ankua Irfani.

Gjysh Afsari u tha: -"Ejani djem! Ne të gjithë dëshirojmë të ndihemi mirë dhe të jetojmë një jetë të sigurt dhe të gjejmë shoqëri të mirë dhe lumturi. Por nuk mjafton vetëm t'i dëshirosh këto. Ne nuk mund të presim që të na i japë dikush tjetër. Të qenit mirë në një ambient të sigurt dhe mbajtja e një shoqërie të mirë kërkon përpjekje dhe sakrificë. Nëse secili prej jush do të këmbëngulte që t'i shkonte gjithmonë e tija dhe do të mendonte vetëm për vete, se sa për t'i bërë lëshime shokut, do të kishte vetëm mërzi dhe grindje midis jush. Por ata që i frikësohen Allahut sillen ndryshe, janë të duruar, e falin tjetrin dhe nuk këmbëngulin t'u shkojë vetëm e tyrja. Edhe sikur dikush t'i dëmtojë, ata nuk hakmerren, por vendosin mirëqenien e të tjerëve përpara dëshirave të tyre personale dhe përpiqen shumë të mos i shqetësojnë ata që kanë përreth. Kjo është një cilësi e sjelljes së lartë, për të cilën Allahu i ka urdhëruar robërit e tij për ta praktikuar."


Enesit i lindi një pyetje: -"Mirë, gjysh, po nëse na vjen një njeri dhe na ngacmon duke përdorur fjalë të këqija, si duhet të sillemi ne?"

Gjysh Afsari u përgjigj: -"Sigurisht, ne duhet të veprojmë ashtu siç na ka urdhëruar Allahu. Ai, në Librin e Tij, na tregon se si:

Një vepër e mirë dhe një vepër e keqe nuk janë njëlloj. Të keqen mbuloje me të mirën, ajo do ta fshijë të keqen edhe, nëse ka armiqësi midis jush, ai do të bëhet miku yt i afërt. (Fussilet: 34)

Profeti ynë, paqja qoftë mbi të, i këshillon muslimanët t'i trajtojnë mirë të tjerët. Në një hadith ai thotë: "... Kush dëshiron të largohet nga zjarri dhe të hyjë në xhenet duhet të vdesë me besim tek Allahu dhe tek Dita e Fundit dhe duhet t'i trajtojë njerëzit ashtu siç do të donte ai ta trajtonin ata ..." (Transmetuar nga Muslimi)

Djemtë u qetësuan nga ato që i tha gjyshi, e falënderuan atë dhe i premtuan se do të përpiqeshin të shkonin mirë me njëri-tjetrin në të ardhmen.



NGA VJEN PËRULËSIA E BESIMTARËVE?

Allahu, në Kuran, i urdhëron besimtarët të jenë të përulur. Profeti ynë, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, gjithashtu thotë në një nga hadithet e tij:

"Allahu më ka shpallur mua se ju duhet të jeni të përulur ndaj njëri-tjetrit. Asnjëri prej jush nuk duhet ta mbajë veten më lart se tjetri dhe as t'i shkaktojë dhunë tjetrit.." (Muslimi)

Besimtarë e dinë se Allahu ka krijuar gjithçka, se çdo gjë i përket Atij dhe është Ai që i ka dhënë njerëzve të gjitha mirësitë që kanë në dorë. Kjo është arsyeja pse, sado të pasur, të bukur, inteligjentë, apo të respektuar qofshin ata, asnjëherë nuk bëhen mendjemëdhenj. Kurani na tregon se besimtarët janë të përulur:

"Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata, që ecin në tokë me përulësi dhe kur të paditurit i drejtohen atyre me fjalë, ata thonë "Paqe."" (Furkan: 63)

Allahu i përgëzon besimtarët për shpërblimin e moralit të tyre të mirë:

"... Zoti juaj është vetëm Një, kështu që nënshtrojeni Atij. Dhe përgëzoi të përulurit. (Haxh: 34)


SI MUND TA PËRKUJTOJMË ALLAHUN?

Besimtarët e dinë se Allahu i sheh dhe i dëgjon në çdo moment dhe Ai vendos për gjithçka që u ndodh atyre. Në çdo moment të jetës së tyre ata e kujtojnë dhe mendojnë për Të. E bëjnë këtë duke u përpjekur ta kenë Allahun në mendje, sepse Ai ka krijuar gjithçka, se Ai ka paracaktuar gjithçka që u ndodh dhe mundohen të kuptojnë çfarë ka pasur për qëllim në këto ngjarje. Ata përpiqen të kuptojnë domethënien e fshehtë të krijimit dhe u tregojnë njerëzve të tjerë për gjithë këto gjëra. Allahu thotë në Kuran se besimtarët e përkujtojnë Atë në çdo kohë:

[Njerëz të mençur janë] ata që e përkujtojnë Allahun kur janë në këmbë, kur janë ulur dhe kur janë shtrirë, dhe thellohen rreth krijimit të qiejve dhe të tokës (duke thënë): "Zoti ynë këtë nuk e ke krijuar kot. Lavdia të qoftë Ty! Na ruaj nga dënimi me zjarr." (Ali Imran: 191)

Në një hadith Kudsi (të shenjtë), Profeti Muhamed, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, e përshkruan përkujtimin e Allahut:

Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: "Unë e trajtoj robin Tim ashtu siç shpreson nga Unë dhe Unë jam me të kur ai më përmend. Nëse më kujton Mua në zemrën e tij, Unë e kujtoj në zemrën Time. Nëse më kujton në shoqëri me të tjerët, Unë e kujtoj atë në një shoqëri më të mirë (me engjëjt). Nëse ai më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem një parakrah. Nëse ai më afrohet një parakrah, Unë i afrohem një krah dhe nëse ai më vjen duke ecur, Unë i vij duke vrapuar. (Buhariu dhe Muslimi)



PASTËRTIA E BESIMTARËVE

Një ditë Zafari ishte shumë i gëzuar. Mësuesi u kishte dhënë si detyrë shtëpie të shpjegonin çdo të thotë të jesh i pastër. Ai i këshilloi të mblidhnin informacion mbi këtë temë nga çfarëdolloj burimi që të mundeshin dhe ta lexonin atë që kishin shkruar përpara klasës. Zafari solli ndër mend gjithçka që dinte për pastërtinë, por ende, ai nuk ishte në gjendje të vendoste 'ia lexonte atë shokëve të klasës. Sigurisht, që për këtë temë kishte shumë gjëra që ai nuk i dinte. Tek po mendohej, i lindi një ide. Meqenëse mësuesi u tha se mund të mblidhnin informacion nga çfarëdolloj burimi që të dëshironin, ai mund të pyeste xhaxhi Hamidin, i cili jetonte në pallatin e tij. Pa e zgjatur, mori stilolapsin dhe fletoren e shënimeve, mori leje nga nëna dhe shkoi tek xhaxhi Hamidi. Ai u kënaq shumë kur mori vesh pse kishte ardhur Zafari dhe menjëherë filluan të flisnin për temën.

-“Xhaxhi Hamid, çdo njeri duhet të jetë i pastër, por disa shokë të mi vijnë në shkollë, në mëngjes, pa larë sytë.”

Xhaxhi Hamidi, pasi e dëgjoi i tha: -"Zafar, Allahu, në Kuran, i urdhëron besimtarët të jenë të pastër dhe të largohen nga çdo gjë e papastër. Ata, që nuk e praktikojnë moralin e Kuranit dhe nuk ndjekin mësimet e tij mbi pastërtinë, bëhen për të ardhur keq. Besimtarët janë fizikisht shumë të pastër. Trupi i tyre, ushqimi, veshja dhe vendi ku ata rrinë janë gjithmonë, çuditërisht, të pastër dhe të rregullt. Ata përpiqen që ta bëjnë çdo vend ku jetojnë që t'i ngjajë pastërtisë së ndritshme së Xhenetit. Në Kuran, Allahu u tregon besimtarëve si duhet ta trajtojnë pastërtinë:

"... Mos më shoqëro Mua asnjë shok dhe pastroje shtëpinë Time për ata që rrethrotullohen rreth saj, të cilët falen në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde." (Haxh: 26)

"O ju që besuat! Hani nga gjërat e pastra që u kemi dhuruar..." (Bekare: 172)

"Patroji rrobat e tua. Dhe të keqes së ndyrë largojtu." (Muddeththir: 4-5)

Zafari, pasi dëgjoi me vëmendje ato që i tha xhaxhi Hamidi, e pyeti: -"Atëherë, çfarë duhet të bëjnë besimtarët me qëllim që të



praktikojnë pastërtinë që këshillon Allahu në Kuran?”

-“Allahu krijoi ujin që të pastrohemi me të, -tha xhaxhi Hamidi, -uji është një bekim i madh dhe një arsye më tepër për ta falënderuar Allahun. Nga gjërat më të rëndësishme që bëjmë është larja e duarve dhe e fytyrës kur ngrihemi në mëngjes si dhe larja e gjithë trupit për ta nisur ditën krejtësisht të pastër. Kurani na tregon se Allahu dërgon ujë nga qielli në mënyrë që njerëzit të pastrohen: “[Ai] ju dërgoi ju ujë nga qielli për t’u pastruar me të dhe për të larguar fëlliqësitë e shejtanit prej jush dhe për të forcuar zemrat tuaja dhe këmbët tuaja.” (Enfal: 11)

-“Në këtë varg,- vazhdoi të fliste xhaxhi Hamidi, -Allahu i paralajmëron njerëzit se shejtani ua bën papastërtinë t’u duket e pranueshme dhe përpiqet t’i pengojë ata nga pastrimi. Ai orvatet t’i largojë njerëzit nga rruga e Allahut dhe vazhdimisht u pëshpërit në mendje vesvese për pastërtinë. Për shembull, ai përpiqet që të na shmangë nga pastrimi i dhëmbëve pas ngrënies apo larjen e rregullt të gjithë trupit, duke na e vështirësuar atë, kështu që me kalimin e kohës ne e harrojmë plotësisht atë. Ndonëse, këto gabime të rastësishme, nuk sjellin pasoja serioze, me kalimin e kohës, ato mund të bëhen dëmtuese për shëndetin dhe pamjen e jashtme. Dhe kjo është ajo që dëshiron shejtani. Ai i urren njerëzit dhe përpiqet t’i tërheqë në Xhehenem, dhe me të vërtetë ai kërkon t’i shikojë duke jetuar në papastërti, me lëkurë dhe dhëmbë të prishura. Por, një njeri që praktikon moralin e Kuranit është vigjilent ndaj këtyre këshillave dhe i zgjuar për të mos rënë pre e pakujdesisë. Kur është fjala për pas-



tërti, ai nuk tregon as pakujdesinë më të vogël. Në çdo situatë, ai është i vetëdijshëm për rëndësinë e saj.”

Zafari, më pas, e pyeti: -“Disa njerëz, edhe pse janë të pastër dhe të paraqitshëm, nuk janë kështu gjithë kohën. Për shembull, ata mund të jenë të pastër dhe të rregullt në ditë festash, por në ditët e tjera duken të parregullt. Si e konsiderojnë ata pastërtinë?”

Xhaxhi Hamidi ia ktheu: -“Disa njerëz, ndonëse nuk e praktikojnë moralin e Kuranit janë shumë të kujdesshëm për pastërtinë. Por, ata janë krejt ndryshe në qëllimet e tyre nga ata që e besojnë Allahun. Qëllimi i tyre është të mos tallen dhe të mos kritikohen nga të tjerët dhe të duken të hijshëm. Kur ata pastrohen, nuk mendojnë ta kënaqin Allahun, prandaj, kur janë vetëm ose me njerëz, nuk shqetësohen fare për pastërtinë, nuk i kushtojnë rëndësi asaj dhe pamjes së jashtme. Por një besimtar i kushton rëndësi të madhe pastërtisë, jo për të kënaqur të tjerët, por për të kënaqur Allahun dhe për t’ju bindur Atij. Edhe kur ai nuk sheh asnjëri për ditë të tëra, është i gjithmonë i pastër dhe i rregullt.”

-“Xhaxhi Hamid, të falënderoj nga zemra për të gjitha këto që më the. Kur të kthehem në shtëpi, do të mendoj për të gjitha këto që më tregove dhe do ta shkruaj detyrën menjëherë dhe, që sot e tutje do të jem më i kujdesshëm për pastërtinë.”- tha Zafari, e përshëndeti xhaxhi Hamidin dhe u largua.

Shkoi në shtëpi dhe filloi të shkruajë. Mezi priste t’ua lexonte atë shokëve në klasë. Gëzimi dhe padurimi që ndjeu për t’u folur shokëve mbi moralin e Kuranit është një nga shenjat e besimtarit.



NAIMI DHE PALLOI I BUKUR


Naimi, me motrën dhe nënën e tij, shkoi në fundjavë në kopshtin zoologjik. Ai habitej tek shihte sa të lezetshme dhe sa të bukura ishin kafshët. Disa nga ata ai i ushqeu, të tjerët i pa nga larg. Një elefant i vogël ia spërkati me ujë fustanin motrës së tij. Naimi dhe nëna e tij qeshën dhe vazhduan të ecnin më tej.

-“Vështro sa i bukur është palloi!”- i tha nëna.

Naimi dhe motra e tij mbetën me gojë hapur nga bukuria e palloit. Ai u afrua për ta parë më nga afër.

-“Përshëndetje, Naim.- i tha palloi. Unë njihem si krijesa më e mrekullueshme në mbretërinë e kafshëve.”

Naimi i tha: -“Bishti yt është me të vërtetë shumë i bukur. Kështu i kanë bishtat të gjithë pallonjtë?”



-“Jo, miku im i vogël. Vetëm ne pallonjtë meshkuj kemi bisht të tillë. Ne e përdorim atë për të tërhequr shoqen tonë.”

Naimi u mendua për një çast dhe e pyeti: -“Kur ti e hap bishtin, nuk mund ta shohësh atë, kështu, si mund të jesh i sigurt se bishti yt është i bukur dhe tërheqës? Dikush duhet të ta tregojë, apo jo? Edhe njerëzit janë të sigurt për pamjen e tyre vetëm kur shihen në pasqyrë.”

-“Ke të drejtë.- i tha palloi. Ne nuk kemi nevojë të shihemi në pasqyrë për të parë sa të bukur jemi. Allahu na mëson se ne jemi të bukur kur i hapim bishtat kështu.”

Naimi u afrua edhe pak dhe mbeti pa mend nga ngjyrat e mrekullueshme dhe vizatimet në bishtin e tij.

-“Më duket sikur po shoh ndonjë pikturë të mrekullueshme; ngjyrat janë kaq të bukura...”- psherëtiu ai.

-“Mendon se unë mund t’i kem pikturuar vetë këto vizatime fantastike në bishtin tim?- e pyeti palloi. Sigurisht që jo, miku im i vogël. Bukuria e jashtëzakonshme e bishtave tanë nuk erdhi vetë. Çdokush mrekullohet nga ngjyrat tona, të cilat askush tjetër përveç Allahut nuk mund t’i krijojë dot.”

Naimi u hodh i emocionuar: “Tani unë e kuptoj më mirë se është Allahu që ju krijoi ju pallonjtë kaq bukur. Mirupafshim, shoku im i mirë.”

Namin e pushtoi një ndjenjë habie nga fuqia e madhe dhe mjeshtëria e Allahut dhe u kthye sërish tek nëna dhe motra e tij. Ai i kujtoi atyre se është Allahu Ai që ka krijuar bukurinë e palloit.





Enveri dhe zogu i vogël



Një pasdite, përpara se të niste detyrat e shtëpisë, Enveri vuri re se kishte filluar të binte shi i madh. E pyeti nënën nëse mund ta shihte pak shiun. Ajo i dha leje për pak kohë dhe ai u afrua tek dritarja dhe filloi të shihte sa këndshëm binte shiu. Në rrugë kishte njerëz që ecnin me nxitim duke mbajtur çadra në dorë. Të tjerët, që kishin mbetur pa çadra, ecnin afër mureve të ndërtesave. Pas pak, filluan të formo-



heshin pellgje gjithkund. Makinat që kalonin me rrëmbim e hidhnin ujin në trotuar dhe kalimtarët, nga frika se mos lageshin, largoheshin tutje. Enveri mendoi, sa mirë ishte që, në një ditë si kjo, ai ishte në shtëpi dhe filloi ta falënderonte Allahun që i kish-te dhuruar ushqim dhe një shtëpi të ngrohtë. Në atë çast, një harabel i vogël u ul në parmakun e dritares. Ai po kërkonte një strehë për t'u mbrojtur nga shiu. Enverit i erdhi shumë keq për zogun dhe menjëherë ia hapi dritaren.

-“Përsëndetje, unë quhem Enver. Mund të vish brenda po të duash.”

-“Faleminderit shumë, Enver. - tha zogu i vogël. Do të më pëlqente të prisja brenda derisa të pushonte shiu.”

-“Duhet të kesh ftohtë,- ia qau hallin Enveri,- unë nuk kam parë asnjëherë një zog kaq afër. Oh, sa të holla i ke këmbët! Si mund ta mbajnë ato trupin tënd?”

-“Ashtu është, Enver, -pohoi harabeli, -ne zogjtë kemi këmbë shumë të holla në krahasim me trupin. Por, megjithatë, ato mund të na mbajnë ne mjaft lehtë. Brenda tyre ka shumë muskuj, vena dhe nerva. Nëse këmbët tona do të ishin pak më të holla apo pak më të trasha, ne nuk do të ishim në gjendje të fluturonim.”

-“Oh, të fluturosh, sa ndjenjë e mrekullueshme duhet të jetë. -Ëndërroi Enveri. Edhe krahët e tu janë të hollë, por ti mund të fluturosh me ta. Si është e mundur që me këta krahë të hollë ti fluturon shumë larg pa u lodhur?”

-“Kur nisim në fillim të fluturojmë, shpenzojmë shumë energji, sepse na duhet që të mbajmë gjithë peshën e trupit në krahët tanë të vegjël,- filloi të tregonte harabeli i vogël. Por, ç'ndodh? Sapo jemi në lartësi, ne qetësohemi duke e lënë veten të udhëhequr nga era. Kështu, ne harxhojmë më pak energji dhe nuk lodhemi. Kur pushon era, ne fillojmë t'i përplasim krahët sërish. Kështu, Allahu na i ka lehtësuar fluturimin në largësi të mëdha.”

Enveri, i cili kishte dëshirë të dinte më shumë rreth tij, e pyeti: -“Po kur je në fluturim, si mund të shohësh përreth?”





Harabeli, i papërtuar, filloi t'i shpjegonte: -"Shqisat më të mira që kemi janë sytë. Përveç aftësisë për të fluturuar, Allahu na ka dhënë gjithashtu një shqisë mjaft të zhvilluar të të parit. Nëse bashkë me aftësinë për të fluturuar nuk do të kishim edhe një shikim të përsosur, do të ishte e rrezikshme për ne të ndërmerrnim ato udhëtime aq të gjata. Ne jemi në gjendje të shohim objekte në largësi shumë më mirë se sa njerëzit dhe kemi një fushë të gjerë shikimi. Kështu, nëse shohim gjatë fluturimit ndonjë rrezik, ne e ndryshojmë drejtimin dhe shpejtësinë. Ne nuk mund t'i lëvizim sytë rreth e rrotull si njerëzit, sepse ata janë të futur në kapakët e tyre. Por ne mund të lëvizim kokën dhe qafën rreth e rrotull dhe shpejt për të rritur fushën e shikimit."

Tani Enveri e kuptoi: "Ah, ja pse zogjtë e lëvizin kokën pa pushim sa andej këndeje, për të parë përreth. A janë të gjithë sytë e zogjve kështu?"

-"Bufi dhe zogjtë e tjerë të natës kanë sy shumë të mëdhenj,- vazhdoi të fliste harabeli. Falë disa qelizave të ve-



çanta që ndodhen në sytë e tyre, ata mund të shohin në dritë të dobët. Kjo është arsyeja pse ata shohin shumë mirë dhe mund të gjuajnë natën. Ka gjithashtu, edhe zogj të tjerë të cilët quhen zogj uji; Allahu i ka krijuar në atë mënyrë, që ata të shohin shumë mirë në ujë. Ata i zhytin kokat në ujë dhe kapin peshk dhe insekte. Allahu ia ka dhënë aftësinë që ata të shohin shumë mirë nën ujë dhe të ushqehen prej tij."

-"Zogjtë nuk i kanë sqepat njëlloj, apo jo. Pse ndodh kështu?"



tu?" - pyeti Enveri.

- "Allahu krijoi lloje të ndryshme sqepash që ndryshojnë nga zogu në zog dhe kjo, për të kryer funksione të ndryshme. - u përgjigj harabeli. Sqepat tanë janë krijuar sipas ambientit ku jetojmë.

Krimbat dhe vemjet janë shumë të shijshëm për ne zogjtë që hamë insekte. Me sqepat tanë të hollë dhe të mprehtë, ne mund t'i kapim ata nën gjethet e pemëve. Zogjtë që ushqehen me peshk, kanë zakonisht sqepa të gjatë, me një formë të përkulur në fund, për të kapur peshkun me lehtësi. Zogjtë që ushqehen me bimë kanë sqepa që u mundësojnë të hanë lehtësisht bimët që u pëlqejnë. Zoti ynë e ka pajisur përsosmërisht çdo krijesë në Tokë me të gjitha aftësitë që i duhen për të jetuar."

Enverit i lindi edhe një pyetje tjetër për harabelin: - "Ti nuk ke veshë si unë, megjithatë, ti më dëgjon mua shumë mirë. Si është e mundur kjo?"

- "Shqisa e të dëgjuarit është shumë e rëndësishme për ne zogjtë. Ne e përdorim atë për të gjuajtur dhe për të lajmëruar njëri-tjetrin për ndonjë rrezik, në mënyrë që të mbrohemi. Disa zogj, për dëgjim, kanë membrana që u lejojnë atyre të dëgjojnë edhe tingujt më të hollë. Për shembull, veshët e bufit janë tepër të ndjeshëm ndaj tingujve. Ata mund të dëgjojnë edhe tinguj që

"A nuk i kanë parë ata shpendët krahëhapur sipër tyre dhe kur krahët i palosin? Askush nuk i mban ata përveç të Gjithëmëshirshmit. Ai sheh gjithçka."
(Mulk:19)





***“A nuk i shohin ata shpendët fluturues
në qiell, të cilët nuk i mban kush, përveç
Allahut. Edhe në këtë ka shenja për
njerëzit që besojnë.” (Nahl: 79)***

njerëzit e kanë të pamundur t’i dëgjojnë.” -tha harabeli.

Enveri nuk rreshtte së pyeturi zogun e vogël: -“Ju zogjtë këndoni shumë bukur. Më pëlqen t’ju dëgjoj. Përse e përdorni zërin tuaj?”

-“Zogu tundi kokën në shenjë pohimi: “Disa nga ne këndojnë këngë të ndryshme për t’i shmangur grabitqarët. Shpeshherë ne i ndërtojmë foletë në zgavrat e trungjeve të pemëve dhe kur ndonjë grabitqar përpiqet të hyjë në fole, zogu vërshëllen si gjarpër. Grabitqari mendon se është gjarpër dhe kështu, foleja mbetet e paprekur.”

-“Çfarë bëni tjetër ju për ta mbrojtur folenë nga armiqtë?” -desh të dinte Enveri.

-“Ne ndërtojmë mjaft fole të rreme për ta shmangur armikun. Në këtë mënyrë, ne i mbrojmë foletë dhe vezët që kemi aty. Për t’i mbrojtur foletë nga gjarpërinjtë helmues, ne i fshehim hyrjet e tyre dhe i bëjmë shumë të ndërlikuara. Një mjet tjetër mbrojtës është se ne i ndërtojmë foletë nëpër pemë që janë me shumë gjemba nëpër degë.”

-“Si është e mundur që disa zogj mund të notojnë në ujë? Dhe pse nuk notojnë të gjithë zogjtë?”- e pyeti Enveri shokun e tij.

Harabeli u përgjigj: -“Allahu ka krijuar disa prej nesh me aftësi në për të notuar. Ai u ka dhënë atyre këmbë si lopata për t’ia lehtësuar notin kur zhyten. Zogjtë e tjerë kanë gishtat e këmbës mjaft të hollë, por pa membrana bashkuese. Kështu, përveç zogjve të ujit, zogjtë e tjerë nuk mund të notojnë.”

-“Tamam si lopata noti!- thirri Enveri. Kur notoj me to, unë notoj shumë më shpejt.”

-“Ka disa lloj zogjsh që i kanë ato të veshura në këmbë qëkur lindin.” -i tha zogu.

Në kohën që ata po bisedonin, nëna i tha të shkante në dhomë





për të bërë detyrat. Por, edhe shiu tashmë kishte pushuar.

Enveri i tha shokut të tij: -"Tani më duhet të shkoj në dhomë për të bërë detyrat. Nesër do t'i tregoj shokëve të mi për aftësitë tuaja të veçanta dhe se si ju ka krijuar Allahu, me mjeshhtëri krijuese të përsosur, ju dhe gjithë krijesat e tjera."

-"Shiu paska pushuar, tani unë mund të shkoj përsëri në fole.- iu përgjigj harabeli i vogël. Të falënderoj që më more brenda, Enver. Kur t'i tregosh shokëve të tu për ato që mësove për ne, a mund t'ju thuash atyre të kujdesen për ne dhe të mos na qëllojnë me gurë as ne dhe as ndonjë krijesë tjetër?"

-"Po, sigurisht që do t'i tregoj.- ra dakord Enveri. Allahu të ruajt kurdoherë!"

Enveri ia hapi dritaren dhe zogu i vogël fluturoi menjëherë. I mbushur në shpirt me mirënjohje për krijimin e mrekullueshëm dhe të përsosur të Allahut, u ul të bënte detyrat.




Shoku i vogël i Aliut

Aliu, bashkë me familjen e tij, shkuan në fshat për piknik një të diel. Nëna shtroi ushqimet mbi një mbulesë në tokë.

Aliut i pëlqenin shumë karotat dhe nëna ia kishte mbushur shportën plot. Sapo mbërritën, ai u ul nën një pemë. Filloi të lexonte një libër dhe, duke lexuar, hante karota. Vuri re se një lepur po i afrohej shportës dhe u ngrit me ngadalë për të mos e trembur lepurushin e vogël.

-“Të ka marrë shumë uria, o lepurush i vogël?” - i tha ai.

-“Oh,... po. Mua më pëlqejnë shumë karotat.” - tha lepurushi.





-“Eja, -i tha Aliu, ‘i hamë bashkë karotat dhe të bisedojmë. Ka shumë gjëra për të cilat, unë dua të të pyes....”

Lepuri filloi të fliste: -“Ne, lepujt, jetojmë në fole që quhen shtrofulla, të cilat i gërmojmë nën tokë. Karotat i shkojnë për mrekulli jetës tonë nëntokësore, sepse ato rriten nën tokë. Kështu, ne mund ‘i gjejmë lehtë. Ato janë ushqimi ynë i preferuar dhe Allahu i ka krijuar në atë mënyrë që, ne të mos mundohemi për ‘i gjetur. Edhe ushqimet e tjera, ne i gjejmë lehtë. Kjo është një nga mrekullitë e krijimit të Tij.”

Aliu mendoi se si Allahu e ka krijuar gjithçka për kafshët në një mënyrë të përshtatshme. Atij iu kujtua portokalli. Në dimër, ai hante shumë portokaj dhe habitej se si i qërohej lëkura dhe ishte i ndarë në thela të vogla, që ai ta hante sa më lehtë. Nëse do të ishte në një formë tjetër, për të do të kishte qenë e vështirë për ta ngrënë. Ata përmbajnë mjaft vitaminë C, e cila i bën shumë mirë shëndetit tonë. Aliu falënderonte Allahun, që i kishte krijuar portokajtë gati, të ndarë në thela dhe të pakeluar, në mënyrë që njerëzit ‘i hanë ato lehtësisht. Sigurisht, është një mirësi tjetër që ne kemi dhëmbë për ‘i ngrënë. Edhe lepujve Allahu u ka dhënë dhëmbët e pammë që ‘i brejnë karotat.

-“Mirë, -i tha Aliu, -çfarë aftësish të tjera të ka dhënë ty Allahu i Plotfuqishëm?”

Lepuri u përgjigj: -“Çdo krijese Allahu i ka dhënë aftësi të tilla që ia lehtësojnë jetesën. Ekzistojnë shumë lloj lepujsh me karakteristika të ndryshme. Për shembull, lepujt që jetojnë në vendet e ftohta janë zakonisht të bardhë. Ata nuk i gjen dot lehtë,



***Për besimtarët ekzistojnë argumen-
te në qiej dhe në tokë. Për një popull
që është sinqerisht i bindur, ka argu-
mente. Edhe në krijimin tuaj edhe në
krijimin e shtazëve të përhapura.
(Xhathije: 3-4)***

sepse fshihen në dëborë. Lepujt e egër, si unë, kanë veshë dhe këmbë më të gjata. Po ashtu, ata që jetojnë në shkretëtirën e Amerikës kanë veshë të stërmëdhenj. Ata i ndihmojnë për t'u freskuar nga vapa e shkretëtirës."

Aliu pohoi me kokë: "Çdo njeri e di atë përrallën për ty dhe breshkën. Ti je një vrapues mjaft i shpejtë, apo jo?"

"Po. -tha lepurit. Këmbët e mia të pasme janë më të gjata dhe më të fuqishme se ato të parmet. Unë mund të vrapoj nga 60 deri në 70 km në orë dhe ndonjëherë kërcëj 6 metra, në një kërcim të vetëm."

"Po, kur je jashtë shtëpisë si e gjen atë? A vjen ndonjë lepur tjetër kur ti nuk je aty?" -deshi të dinte Aliu.

"Disa kafshë lenë një aromë karakteristike në follenë e tyre. Për shembull, gazelat lenë pas një substancë që del nga një gjëndër, e cila ndodhet nën sytë e tyre. Aroma e kësaj substance e bën të dallueshëm territorin ku ato jetojnë. Edhe ne, lepujt, kemi gjëndra të tilla në nofull dhe shtrofullat tona marrin aromë prej saj.

Asnjë lepur tjetër nuk futet brenda dhe ne i gjejmë shumë lehtë ato. Sigurisht, këtë ne nuk jemi në gjendje ta bëjmë vetë, por, është Allahu Ai që na krijuar kështu."


-“Po ti, ke motra apo vëllezër të tjerë?” -e pyeti Aliu.

-“Ne, lepujt, shtohemi shumë shpejt, -u përgjigj ai. Nënata lepuj i mbajnë të vegjlit e tyre vetëm për 28-33 ditë. Ato lindin shumë lepurusha njëherësh. Unë kam 15 motra dhe vëllezër ... Lepurushat e vegjël qëndrojnë me nënën e tyre për rreth një muaj. Lepujt kanë edhe një tipar tjetër: ata mund të çiftohen 3-4 ditë pas lindjes.”

Në atë çast, erdhi babai i Aliut dhe u bashkua në bisedë me ta.

-“Edhe unë nuk i dija të gjitha këto, lepurush i vogël, -tha ai. Allahu ta shpërbleftë me të mira! Sa i mrekullueshëm është i gjithë universi që ka krijuar Ai dhe çdo gjë në të. Në Kuran, Zoti ynë i Plotfuqishëm thotë:

Ai është Allahu, Zoti juaj.
Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, Krijuesi i gjithçkaje. Adhurojeni Atë. Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi.(En’am: 102)



Ai na i ka dhuruar të gjitha mirësitë që kemi, në mënyrë që ta falënderojmë dhe të fitojmë kënaqësinë e Tij në këtë jetë, ku po kalojmë provat, të cilat do të na përgatitin për jetën e përjetshme. A e dini ju se Allahu na thotë në Kuran se na ka krijuar vetëm që ta adhurojmë? Gjëja më e mirë që mund të bëjmë është ta falënderojmë për të gjitha mirësitë dhe ta drejtojmë jetën tonë sipas Librit të Shenjtë dhe të jetojmë vetëm për ta kënaqur Atë. Allahu thotë në Kuran:

“Përkufizojë veten me ata që lusin Zotin mëngjes e mbrëmje dhe që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij. Mos i kthe sytë prej tyre e të kërkosh bukuritë e kësaj bote. E mos iu bind atij që ai kemi shmangur zemrën nga përkujtimi ynë dhe ndjek dëshirat e tij dhe i ka kaluar të gjithë kufijtë.” (Kehf: 28)

-“Babi, -foli Aliu. Nëse do të vështronim përreth dhe do të mendonim, ka kaç shumë gjëra për të cilat ne duhet të jemi falënderues, apo jo? Qoftë kjo një pemë që shohim përditë, një zog që fluturon, një lepurush i vogël... Kur shohim këto gjëra me vëmendje, vëmë re një projektim të përsosur në secilën prej tyre. Vetëm fuqia krijuese e Allahut të Plotfuqishëm është në gjendje t’i bëjë të gjitha. Ndryshe, si do të mundej një lepur të ishte aq i zgjuar sa t’i fitonte vetë të gjitha këto cilësi?”

-“Ashtu është, Ali, -u përgjigj lepuri. Nëse Allahu nuk do të na i kishte dhënë këto aftësi kur na krijoi, as njëri prej nesh nuk do të kishte fuqi t’i bënte vetë ato.





Babai i Aliut shtoi: -"Ali, bëmë shumë mirë që erdhëm këtu për piknik. Në fillim ti nuk doje të vije me ne, por, shiko sa mirë që njohe këtë lepur të vogël dhe biseda me të, të ka bërë të mendosh për ca gjëra."

Ke të drejtë babi. -"Biseda jonë më ka ndihmuar ta shoh Allahun kudo. Faleminderit lepurush. Tani unë me babin po largohemi. Do ta pyes mamën nëse kemi karota të tjera apo jo dhe, nëse kemi, do të t'i sjell. Mirupafshim."

-"Faleminderit Ali, -tha lepurushi, -Allahu të bekoftë!"





MAKSUDI DHE KOTELJA

Kur erdhi Maksudi nga shkolla, e priste një surprizë e këndshme. Babai i kishte blerë një kotele të vogël. Pasi mbaronte detyrat e shëtisë, ai e kalonte kohën duke luajtur me kotelen e lezetshme. Një natë, kur ai ndodhej shtrirë në krevat, u habit shumë kur pa se, ajo doli nga dhoma dhe e gjeti tasin me qumësht në errësirë të thellë, në kuzhinë.

-“Si e gjete tasin me qumësht kaq lehtë në errësirë?” -pyeti i çuditur Maksudi.

-“Ne nuk kemi nevojë për shumë dritë për të parë, Maksud, -zuri të fliste macja me atë gërhitjen e saj. Sytë tanë janë krijuar ndryshe nga tuajit. Në errësirë, bebëzat e syve tanë hapen mjaft, në mënyrë që të futin brenda sa më shumë dritë. Ne, macet, kemi një shtresë në sy që njerëzit nuk e kanë; ajo ndodhet prapa retinës dhe e reflekton dritën. Në këtë mënyrë drita kalon nëpër retinë dy herë. Kjo është arsyeja pse ne shohim mirë në errësirë dhe na ndritin sytë. Allahu na ka krijuar me të gjitha aftësitë për të mbijetuar në të gjitha llojet e kushteve. Është si-

**Musai tha: "Ai, për të cilin flas, është
Zoti i Lindjes dhe Perëndimit dhe
gjithçka ka midis tyre, siç mund ta
dini, nëse do të vinit në punë mend-
jen." (Shu'ara': 28)**

gurisht e pamundur, ashtu siç pretendon teoria e evolucionit, që ne i zhvilluam këto aftësi rastësisht, me kalimin e kohës. Allahu krijoi macet dhe të gjitha gjallesat përsosmërisht dhe në të njëjtën kohë."

Maksudi mendoi për një çast dhe tha: "Ne, njerëzit e dimë se, nëse ti bie nga një vend i lartë, gjithmonë bie në këmbë dhe nuk vritesh. Si ia arrin kësaj?"

- "Ashtu është, -i tha macja, neve na pëlqen shumë të ngjitemi
nëpër pemë.

Allahu na e ka dhënë këtë mun-
dësi të veçantë për të na
mbrojtur, nëse rrëzo-
hemi. Kur biem, ne e
përdorim bishtin
për të mbajtur eku-
ilibrin, ndryshojmë
qendrën e gravitetit



të trupit tonë dhe biem drejt e në këmbë. Kjo aftësi mbrojtëse tregon mëshirën e madhe dhe dhembshurinë e Allahut.”

Maksudi e mori atë me kujdes në prehër. Çdo ditë, kur shihte ndonjë nga këto krijesa të vogla të lezetshme, ai mendonte se sa prova të mrekullueshme na rrethojnë, të cilat tregojnë fuqinë dhe mjeshërinë krijuese të Allahut. Dashuria dhe dhembshuria që ndiente për macet u rrit edhe më tepër. Edhe kotelja e vogël e tregonte dashurinë e saj për Maksudin, sepse, sa herë që ai e përkëdhelte mbi gëzofin e butë, ajo gërhiste e kënaqur që kishte një shok kaq të mirë.

A nuk e shihni se Allahu ua ka bërë gjithçka ka në Tokë t'ju nënshtrohet, edhe anijet që lundrojnë në det me urdhrin e Tij? Ai e mban qiellin, që të mos bjerë në Tokë, përveç me lejen e Tij. S'ka dyshim se Allahu Mirëbërës, Mëshirues ndaj njerëzve. (Haxh: 65)



Macet tona



SEJIDI DHE KALLAMARI

Sejidi përfitoi nga pushimet e verës duke bërë not sa të mundej. Babai i kishte dhuruar një palë syze palombari, që të shihte nën ujë. Ai u ngazëllye vërtet kur pa mrekullitë nënujore. Njëherë, teksa po shihte me syzet e tij, ai pa diçka që nuk ngjante si peshk.

-“Hej, kush je ti?” -i thirri Sejidi.

-“S’është çudi që ti nuk e di, Sejid! -iu përgjigj krijesa. Unë jam një kallamar. Shpesh njerëzit mendojnë se ne jemi peshq, ndonëse, ne ndryshojmë shumë nga peshqit. Për shembull, ne nuk kemi asnjë kockë në trup.”

Sejidi mbeti i habitur: -“Nëse nuk ke asnjë kockë në trup, atëherë si ia bën për të lëvizur?” -e pyeti ai.

-“Nëse do të dish të vërtetën, -u përgjigj kallamari, -ne lëvizim në një mënyrë që do të të habitë ty. Trupat tanë janë shumë të butë dhe lëkura jonë është shumë e trashë. Në lëkurë, ne kemi muskuj që i përdorim për të futur ujin brenda dhe më pas e nxjerrim jashtë me forcë. Ja se si notojmë.”

-“Mund të ma tregosh, si e bën këtë?” -i tha Sejidi.


Kallamari nisi t’i shpjegonte: -“Në të dyja anët e kokës ne kemi dy çar-

je si xhepa. Nëpërmjet tyre ne e tërheqim ujin në një zgavër në trup dhe më pas e nxjerrim ujin me presion të madh nga një tub i hollë, i cili ndodhet nën kokë. Në sajë të forcës që krijohet, ne mund të lëvizim në drejtim të kundërt nga del uji. Kështu mund të largohemi shpejt nga ndonjë grabitqar që është duke na ndjekur.”

-“E kuptova, -tha Sejidi, -po, nëse nuk je edhe aq i shpejtë për t’u larguar, si ia bën?”

-“Nëse nuk arrijmë dot të largohemi në kohë, ne nxjerrim nga trupi një re boje të errët dhe ia spërkasim armikut, i cili mbetet i shushatur. Na duhen vetëm disa sekonda për të marrë situatën në dorë. Tashmë armiku nuk na sheh nëpër atë re të errët dhe ne largohemi.”





Sejidi këtë herë mbeti pa gojë: -"Allahu të ka përgatitur për çdo vështirësi që mund të hasësh. Nuk ma ha mendja se si, ne, njerëzit, ashtu edhe ju kafshët, mund t'i kemi fituar këto aftësi vetë."

-"Ashtu është, Sejid. Kjo është vepër e diturisë gjithëpërfshirëse të Allahut të Plotfuqishëm. Ai i ka krijuar të gjitha gjallesat që të zë syri, me gjithë cilësitë e tyre të mrekullueshme. Asnjë krijesë nuk është në gjendje t'i fitojë vetë ato. Fuqinë dhe diturinë e Allahut mund ta shohim kudo dhe nuk ka fuqi përveç me ndihmën e Tij."

-"Jam shumë i gëzuar që të takova. Të falënderoj shumë për të gjitha këto që më mësove." -tha Sejidi dhe u largua duke notuar.

**Ai është Allahu,
nuk ka të adhuruar tje-
tër veç Tij, Ai është i Gjalli
që nuk ka nevojë për askënd.
Atë nuk e kap as kotje as gjumë.
Çdo gjë në qiej dhe në tokë i përket
vetëm Atij. Kush mund të ndërmjetë-
sojë tek Ai pos me lejen e Tij? Ai e di
të tashmen dhe të ardhmen, por ata
nuk mund të dinë nga dija e Tij vetëm
aq sa Ai ka dëshiruar. Froni i tij
përfshin qiejt dhe tokën dhe
kujdesi ndaj tyre
asnjëherë nuk e lodh Atë. Ai
është më i Larti, më i
Madhi. (Bekare: 255)**



QEMALI DHE KALI I DETIT

Qemali kishte shkuar me familjen e tij për pushime, pranë një plazhi, në një kamp pushimi. Përpara një dyqani të vogël, ndodhej një akvarium me disa kafshë deti mjaft interesante. Qemali u ngjiti lart te akvariumi dhe pa një kalë deti që po sillej vërdallë, qetë-qetë.


-“Qenke kaq i vogël, -iu drejtua Qemali. Unë mendoja se ju kuajt e detit ishit më të mëdhenj.”

-“Ke të drejtë, -iu përgjigj kali i detit. Ata që na shohin nëpër libra dhe në televizor mendojnë se ne jemi shumë më të mëdhenj se aq, por ne jemi vetëm 4 deri 30 cm të gjatë.”

Qemali iu afrua për ta parë më nga afër: -“Sytë tuaj mund të lëvizin në çdo drejtim, apo jo? Në këtë mënyrë ti mund ta kuptosh çfarë bëhet rreth e rrotull teje.”

-“Ashtu është, -pohoi ai. Allahu na i ka krijuar kokën në kënd të drejtë me trupin. Asnjë krijesë tjetër detare nuk është kështu si ne. Për këtë arsye ne





notojmë me trupin në pozicion vertikal dhe kokën mund ta lëvizim vetëm lart e poshtë. Nëse edhe krijesat e tjera të detit do ta kishin këtë cilësi, do ta kishin vështirë për të kthyer kokën anash dhe nuk do të mundeshin të mbroheshin nga rreziqet. Por ne nuk e kemi këtë problem, për shkak të projektimit të veçantë të trupit tonë.

Allahu i Plotfuqishëm i ka krijuar sytë tanë të pavarur njëri nga tjetri dhe të zhdërvjellët për të lëvizur në çdo drejtim. Ata mund të rrotullohen dhe të shohin në çdo drejtim. Edhe pse nuk mund ta kthejmë kokën anash, ne mund të shikojmë përreth. Nga shumëllojshmëria e madhe e formave dhe cilësive të habitshme tek krijesat e ndryshme, ne kuptojmë mjeshtërinë e përsosur dhe diturinë e pakufishme të Allahut.”

Qemali pati rastin ‘i bënte edhe një pyetje tjetër kalit të vogël të detit dhe i tha: -“Jam shumë kurioz për diçka. Ti nuk ke as fletëza notimi as bisht, si ia bën që zbret dhe ngjitesh në ujë?”

-“Ne kemi një sistem të veçantë për të notuar. Kemi xhepa notimi të mbushura me një lloj gazi brenda. Ngjitemi dhe zbresim duke bërë ndryshimet e nevojshme në sasinë e këtij gazi. Nëse do të na dëmtohej xhepi i ajrit, ne do të fundoseshim në fund të detit. Me fjalë të tjera, nëse sasia e gazit në xhepat e notimit do të ishte më e vogël ose më e madhe, ne do të vdisnim. Zoti ynë na i ka krijuar këtë sasi me shumë kujdes.”

-“Oh, çfarë krijim i mrekullueshëm!”- mori frymë thellë Qemali.

-“Siç e sheh, shoku im i vogël, -vazhdoi të fliste ai, -Allahu na ka krijuar ne kuajt e detit dhe të gjitha krijesat në univers, me të gjitha cilësitë e përsosura. Ne jemi vetëm një shembull nga shumë lloje gjallesash nënujore dhe krijimi ynë është tregues i fuqisë së pamatë dhe diturisë së pafund të Allahut.”

Kur mbaroi bisedën interesante me kalin e detit, Qemali u kthye tek nëna e tij. Kjo kafshë e vogël e kishte të bërë të meditonte mbi mjeshtërinë krijuese të Allahut.

Qerimi dhe gjysh HASANI

Qerimi po shihte në dritare dhe po priste me padurim gjyshin. Ai kënaqej shumë kur rrinte me gjysh Hasanin. Më në fund gjyshi erdhi. Qerimi vrapoi i ngazëllyer drejt derës dhe e përqafoi fort. Ashtu siç e kishte pritur, gjyshi i kishte sjellë një dhuratë, një lodër të dashur dhe disa libra me figura. Gjyshit i pëlqente shumë kur nipi i tij kënaqej dhe i tha: -"Sot, unë kam diçka për të bërë jashtë qytetit, të pëlqen të vish me mua? Do të kënaqemi bashkë."

Qerimi pranoi i gëzuar dhe ikën. E lanë pas qytetin. Qerimi me të vërtetë po kënaqej nga ky udhëtim i papritur .

-"Ajri është kaq i pastër, -mori frymë thellë ai. Sot do t'i mbushim mushkëritë me ajër të pastër. Sa do të doja që edhe në qytet ajri të ishte i tillë."



-“Ah, kjo do të ishte pak e vështirë, Qerim, -iu përgjigj gjyshi, -sepse tymi i makinave, ndotja e oxhaqeve, veçanërisht në dimër, dhe mungesa e pemëve dhe e bimëve të tjera e pengon ajrin e qytetit që të pastrohet.”

Qerimi po vriste mendjen dhe pyeti gjyshin: -“E kuptoj që tymi e ndot ajrin, por nuk arrij ta kuptoj çfarë lidhje kanë bimët me ajrin. Pemët mbillen për të prodhuar fruta dhe për të zbukuruar qytetin, apo jo?”

-“Po, -u përgjigj gjysh Hasani, -është e vërtetë se pemët mbillen për këto arsye, por ç’është më e rëndësishmja, ato pastrojnë ajrin. Bimët thithin atë që ne nxjerrim nga mushkëritë tona. Njerëzit dhe kafshët marrin oksigjen nga ajri dhe, pasi e thithin atë në mushkëri, nxjerrin dioksid karboni. Por, bimët bëjnë të kundërtën: ato thithin dioksid karboni dhe nxjerrin jashtë oksigjen. Ja si pastrohet ajri. Bimët kanë edhe veti të tjera të mrekullueshme, o Qerim, dhe është Allahu i Gjithëdijsëm, i cili i ka krijuar të gjitha këto. Nëse të pëlqen unë mund të të tregoj diçka për bimët.”

-“Po, të lutem, gjysh!” - brohoriti Qerimi me gëzim.

Gjysh Hasani mori frymë thellë dhe filloi të flasë: -“Bimët marrin frymë në një proces që quhet fotosintezë.”



FOTOSINTEZA

-“Çfarë është fotosinteza o gjysh?” -e ndërpreu Qerimi.

-“Do të përpiqem të ta shpjegoj, -i tha gjyshi, -por nuk do të jetë e lehtë, sepse është shumë e vështirë dhe e ndërlikuar. Madje, edhe vetë shkencëtarët janë ende duke u përpjekur ta kuptojnë këtë proces.”

Qerimi u mendua për një çast dhe tha: -“Bimët mbijetojnë në sajë të një procesi që shkencëtarët ende po përpiqen ta shpjegojnë. Kur thua fjalën “proces” mua më vijnë ndër mend ekuacione dhe formula matematike. Edhe neve, ndonjëherë, matematika na duket e vështirë, por, bimët që nuk kanë as mendje dhe as trup si yni mund të merren me të. Është vërtet një mrekulli!”

Gjysh Hasani buzëqeshi e tha: -“Po, është plotësisht një mrekulli. Nga



dita që janë krijuar e deri më sot, bimët vazhdojnë ta kryejnë këtë proces kimik pa asnjë lloj vështirësie. Kudo që ndodhen bimët e gjelbra, atje ka një “fabrikë që prodhon sheqer” nga dioksidi i karbonit dhe uji duke shfrytëzuar dritën e Diellit. Spinaqi që hamë në gjellë apo sallata jeshile, ndonëse u mungon vetëdija, janë në gjendje prodhimi të vazhdueshëm për ne. Kjo është shenjë e mëshirës së madhe që ka mbi ne Allahu i Plotfuqishëm, që me diturinë e Tij ka përfshirë gjithçka. Ai i ka krijuar bimët në dobi të njerëzve dhe të kafshëve. Ky proces i përsosur, që teknologjia moderne njerëzore nuk mund ta kuptojë plotësisht, është zhvilluar nga gjethet për miliona vjet me radhë. Në Kuran, Allahu na tre-

gon se një njeri nuk mund të krijojë madje as edhe një pemë nga asgjëja: "Ai krijoi qiejt dhe tokën dhe dërgon shi prej së larti, me anë të të cilit bëjmë të rriten kopshtet e pasura. Ju nuk mund t'i bëni asnjëherë ato të rriten..." (Neml: 60)

Qerimi kishte mbetur i mahnitur nga fakti që bimët marrin frymë me këtë proces kimik të veçantë që quhet fotosintezë.


"Po si ndodh ky proces?" -po mendohej ai.

E, ndërsa po mendonte kështu, gjyshi vazhdoi të shpjegonte: -"Bimët e pavetëdijshme, duke përdorur dheun, ujin, ajrin dhe dritën e diellit, marrin një sasi mineralesh dhe uji nga toka dhe prodhojnë ushqim për njerëzit. Në sajë të energjisë që marrin nga Dielli, ato i ndajnë këto materiale dhe më vonë i bashkojnë përsëri bashkë për të prodhuar ushqim. Ky është vetëm një shpjegim i shkurtër i këtij procesi, por në çdo hap mund të shohësh se prapa tij qëndron një plan i vetëdijshtëm dhe inteligjent. Është e qartë, se qëllimi i këtij sistemi të habitshëm që funksionon tek bimët është të japin një burim jete, të vënë në punë për mirëqenien e njerëzve."



-“Mirë, po çfarë bëjnë gjethet?” -pyeti Qerimi kurioz.

Gjysh Hasani vazhdoi t’i shpjegonte: -“Ti i ke parë mikroskopët në laboratorin e shkollës me të cilët ne studiojmë? ... Nëse do të shihnim një gjethë me një mikroskop shumë të përparuar, do të shihnim edhe një herë mrekullinë e mjeshtërisë krijuese të Allahut. Në çdo gjethë ekziston një sistem prodhues i përsosur. Me qëllim që ta kuptosh më lehtë se çfarë ndodh brenda në gjethë, do ta krahasoj me makineritë që përdorim në jetën e përditshme. Nëse do të zmadhojmë pjesët përbërëse të një gjethë, do të shihnim një fabrikë ushqimi automatike me tuba që punojnë vazhdimisht, me dhomëza për procese të veçanta, valvula që punojnë si tenxhere me presion dhe butonë pa numër, të cilët kontrollojnë mijëra procese. Dhe nëse do të hidhnim një vështrim më në thellësi, do të shihnim kohëmatës, termostate, pajisje për ruajtjen e lagështisë, mekaniz-



ma të rregullimit të nxehtësisë, sisteme të përkthimit të informacionit në pika të veçanta.”

Qerimi u mendua për një moment dhe tha: -“Është me të vërtetë një mrekulli që gjithë këto gjëra janë bashkuar në një gjethe të vetme dhe punojnë pa asnjë problem.”

-“Është Zoti ynë, Allahu, i cili e ka shpikur dhe projektuar këtë sistem të habitshëm.” -e kujtoi Gjysh Hasani nipin e tij. Me lejen e Allahut, çdo gjethe në botë krijohet me këtë sistem të fantastik. Mos e harro këtë.”

Ndërsa po dëgjonte gjyshin, Qerimi pa një pemë të madhe dhe në kokë i lindi një pikëpyetje. Filloi të vriste mendjen si mund të mbi jetonte një pemë pa e zgjidhur atë problem. Menjëherë pyeti gjyshin: -“Gjysh, pemët janë shumë të larta. Si e tërheqin ato ujin dhe ushqimin nga toka? Shih atë pemë! Është shumë e lartë, por megjithatë, gjethet në majë janë ende të gjelbra.”

Gjyshi tundi kokën dhe i tha: -“A të kujtohet? Pak më parë unë i krahasova gjethet me një fabrikë; le ta përdorim të njëjtin krahasim përsëri. Imagjino një sistem tubacionesh me një rrjet të tërë që e rrethon atë; ky sistem siguron që lënda e parë që vjen nga toka mbërrin në njësitë e prodhimit dhe prodhimi, i përfutur nga këto njësi, shpërndahet në lëngun e sheqerosur që prodhohet në gjethe në drejtim të sipërfaqeve të tjera, në mënyrë që e gjithë pema të rritet. Këto ka-




nale nuk shërbejnë vetëm për të transportuar këtë lëng jetësor; ata shërbejnë gjithashtu si sistem skeletik për pemët dhe gjethet. Në një ndërtesë që ndërtohet nga njerëzit, pjesët përbërëse që e mbajnë atë (kolo-nat dhe trarët) dhe sistemi hidraulik ndërtohen veçmas. Është mrekulli që tek bimët këto dy elemente jetësore bashkohen në një.”

Qerimi i menduar tha: -“Ky është një sistem i mrekullueshëm. Unë po vras mendjen...është sikur të kishte brenda bimës një kalendar ose një orë që i bën të njëjtat gjëra gjithë kohën pa u ngatërruar. Për shembull, çdo pranverë lulet çelin dhe çdo vjeshtë gjethet bien nga pema. Si ndodh kjo, o gjysh?”

Si e ngjitin bimët ujin lart?






-“Shkencëtarët këtë e quajnë orë biologjike, -i shpjegoi ai. Kohëmatësit që bëjnë ndërrimin e orës për bimët llogaritin për sa kohë bien rrezet e diellit mbi gjethë. Këto orë biologjike e llogaritin këtë gjatësi kohe ndryshe për çdo bimë. Si rezultat i eksperimenteve që janë kryer me sojat, ne e dimë se këto bimë lulëzojnë çdo vit në të njëjtën kohë, pa marrë parasysh se kur mbillen. Është sigurisht Allahu i Plotfuqishëm që bën këto rregullime të kohës tek bimët.”


Duke ecur, gjysh Hasani dhe nipi i tij, u ndalën pranë një kopshti buzë rrugës. Pasi i morën leje pronarit, këputën disa kumbulla, i lanë dhe filluan t’i hanë. Ato ishin shumë të shijshme. Gjyshi e pyeti Qerimin: -“Qerim, a di ti se energjia që na japin bimët vjen nga Dielli?”

Qerimi u habit dhe ia ktheu: -“Çfarë do të thuash me këtë, se kur hamë këto kumbulla jemi duke ngrënë diellin?”

Gjyshi buzëqeshi dhe tha: -"Po, e hamë diellin, por jo drejtpërdrejt. Ne të gjithë e dimë se burimi kryesor i energjisë për tokën është dielli. Por, njerëzit dhe kafshët nuk e përdorin këtë energji direkt, sepse ne nuk kemi sistemet e duhura. E di se si e përdorim atë? Njerëzit dhe kafshët mund të marrin vetëm energji të përdorur nga elementët ushqyes që ndodhen tek bimët. Energjia që përdorim ne është vërtet energjia e Diellit që na jepet nga bimët. Kur pimë çaj ne jemi duke thithur energji nga Dielli; kur hamë bukë ajo është një pjesë energjie mes dhëmbëve tanë. Fuqia që ndodhet në muskujt tanë është një gjendje e ndryshuar e energjisë diellore. Në sajë të kësaj energjie ne vrapojmë dhe luajmë. Tani lind pyetja: Si e bëjnë bimët këtë? Bimët kryejnë disa operacione të ndërlikuara me qëllim që të ruajnë energjinë diellore për ne. Ajo që u mundëson atyre të prodhojnë vetë ushqimin e tyre dhe që i dallon nga qeniet e tjera të gjalla është se qelizat e tyre ndryshojnë nga qelizat e njerëzve dhe të kafshëve. Ato kanë disa struktura në qelizat e tyre që u mundësojnë ta përdorin direkt energjinë e Diellit. Me ndihmën e këtyre strukturave, ato e transformojnë energjinë diellore në një formë të tillë që njerëzit dhe kafshët ta përdorin për ushqim dhe ato e ruajnë këtë energji në ushqim duke përdorur një formulë speciale të fshehtë."

-"Kjo është e mrekullueshme!" -brohoriti Qerimi i kënaqur. Allahu ka krijuar gjithçka në shërbim të njerëzve!"






Gjysh Hasani pohoi duke tundur kokën dhe ia ktheu: -“Kështu që ne duhet të mendojmë për të gjitha këto dhe të falënderojmë Zotin tonë që na ka dhënë mirësi që nuk numërohen. Allahu na thotë në Kuran se ne duhet ta falënderojmë: “Në mënyrë që ata të hanë frutat e tyre, ata nuk i krijuan ato vetë. A nuk duhet të jenë falënderues?” (Ja Sin: 35)

Lënda që i pëlqente më shumë Qerimit ishte dituria e natyrës. Papritur i erdhi në mendje një eksperiment që kishin zhvilluar në shkollë. U kthye nga gjyshi dhe i tha: -“Gjysh, ne një ditë bëmë një eksperiment në shkollë. Mësuesi na e dha për detyrë shtëpie të vendosnim disa kokrra fasule në një copë pambuk, në një vazo qelqi, ta vendosnim atë në një vend me diell dhe ta ujitnim për disa ditë. Gjeje çfarë ndodhi?”

Gjyshi buzëqeshi përsëri dhe tha: -“Fasulet mbinë, apo jo? Le të mendojmë pak për këtë. Kjo tregon një dukuri natyrore bazë, e cila është një mrekulli. Ti ke parë nëpër shfaqje cirku si nxirret një lepur nga një kapele, apo jo? Kjo i ngjan një bime që mbin në një copë pambuku ose nën tokë. Sidoqoftë, në një shfaqje cirku, sytë tanë gënjen, por një bimë që vjen nga një farë e vogël nuk gënjen dot asnjë. Zoti ynë i Gjithëdijshtëm,





me mrekulli të tilla, i krijon bimët nga farat e vogla dhe na tregon qartas se asnjë gjallesë nuk ekziston rastësisht. Ata që thonë se gjërat e gjalla kanë ardhur në këtë botë rastësisht, gënjejnë vetveten, apo jo, Qerim?”

–“Po, gjysh.” -tha Qerimi i gëzuar.

Gjysh Hasani vazhdoi të fliste: –“Një pjesë e bimës që del nga një farë e vogël shkon nën tokë, ndërsa një pjesë tjetër rritet sipër. Dheu është shumë i ashpër dhe i ngjeshur dhe është shumë e vështirë të rritet në të dy drejtimet. Këta filiza të vegjël nuk kanë inteligjencë dhe vetëdije si ne, prandaj është një mrekulli si ia dalin mbanë kësaj.”

–“Vetëm imagjino ç’do të ndodhte sikur të mbillnim një farë në tokë dhe të mos mbinte. -thirri Qerimi. Atëherë ne të gjithë do të kishim probleme të mëdha për të gjetur ushqim. E nëse nuk do të gjenin ushqim, të gjithë njerëzit dhe kafshët do vdisnin dalëngadalë.”

Gjyshi tundi kokën në shenjë pohim dhe tha: –“Allahu na paralajmëron në Kuran, Qerim: “A keni menduar për atë që e mbillni? E bëni ju atë të mbijë apo Ne jemi zbërthyesit e saj? Sikur Ne të dëshironim, do ta bënim atë të thyer e ju do të mbeteshit pa të të shqetësuar, (pa të korra).” (Uakia: 63-65)”

Kur po ecnin, Qerimi filloi të mendohej për ato që i kishte treguar gjyshi. I tregoi atij për atë që po mendonte duke i thënë: –“Gjysh, bimët janë të rëndësishme për mbijetesën tonë. Ato pastrojnë ajrin që ne thithim, na ushqejnë dhe na japin energji, na



japin fruta të shijshme dhe perime dhe e zbukurojnë edhe natyrën. Vetëm hidh vështrimin atje! Shih sa pemë të llojlojshme, lule, fruta dhe drithëra ka!”

-“Është edhe një mirësi tjetër që ti e ke harruar. -tha gjyshi. Ai vjen nga bimët dhe Allahu na tregon në Kuran për të: **“Ai prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin e ju prej tij ndizni.”** (Ja Sin: 80)”

-“Po, si e harrova unë këtë? -tha Qerimi. Ne djegim drutë që priten nga pemët për të na mbajtur ngrohtë. Edhe librat tanë, fletoret, gazetat dhe të gjitha llojet e letrës prodhohen nga lënda e parë që është druri; shkrepëset, po ashtu, me të cilat ndezim zjarrin, kolltukët e rehatshëm ku ulemi, tryezat, dyert, dritaret...”

Gjyshi Hasani tundte kokën i kënaqur nga ato që thoshte Qerimi. Ai shtoi:-“Përveç përdorimit të tyre të shumanshëm, bimët kanë edhe një karakteristikë tjetër. Një bimë kacavjerrëse që rritet në Amerikën Qendrore dhe atë të Jugut tërheq dhe jep ushqim ideal për krimbat e zinj dhe të gjelbër dhe fluturat e kuqe. Këto insekte i vendosin vezët e tyre mbi këtë bimë në mënyrë që, kur ato



të çelin, ta kenë për të ngrënë këtë ushqim të shijshëm. Por, ajo që është më e rëndësishme është se, fluturat, përpara se të vendosin vezët mbi këtë bimë, kontrollojnë gjethet. Nëse një insekt tjetër ka lënë vezët atje, ato e kuptojnë se do të jetë e vështirë për të ushqyer dy familje nga gjethet e së njëjtës bimë, kështu që ato vendosin të shohin një tjetër me gjethe të lira.

Kjo bimë kacavjerrëse formon gunga të gjelbra mbi sipërfaqen e gjetheve të saj dhe disa varietete formojnë njolla që i ngjajnë vezëve të fluturës, pikërisht nën gjethet, në pikën ku ajo bashkohet me degën. Kur i shohin vemjet dhe fluturat këto, mendojnë se një tjetër insekt ka lëshuar vezët i pari mbi këto gjethe. Atëherë, ato nuk i lëshojnë vezët atje, por kërkojnë një tjetër vend.”

-“Çfarë sistemi mbrojtës i mrekullueshëm!” -tha Qerimi i habitur.

-“Ashtu është Qerim, -përfundoi bisedën gjysh Hasani. Është Allahu me diturinë e Tij të pakufishme Ai që i ka mësuar kësaj bime se si të mbrohet. Mos e harro kurrë këtë!”



Idrisi sapo u kthye nga shkolla, vrapoi tek gjyshi për ta pyetur për diçka që kishte në mendje.

-“Gjysh, dua të të pyes për diçka.” -tha ai.

-“Fol Idris!” -i kërkoi gjyshi.

-“Në autobus, një zonjë po i tregonte shoqes së saj se sa i rëndësishëm është durimi dhe se si duhet të jetë durimi i vërtetë ashtu siç përshkruhet në Kuran. Mund të më tregosh, të lutem, çdo të thotë kjo?”

Gjyshi filloi të fliste: -“Shumë njerëz nuk e dinë ç’është durimi i vërtetë apo si duhet të sillet një njeri durimtar. Disa njerëz mendojnë se durim do të thotë vetëm t’i përballosh fatkeqësitë dhe pengesat që të dalin përpara në jetë dhe të pajtohesh me to. Por, Allahu na mëson në Kuran se durimi i vërtetë është diçka shumë e ndryshme nga të pajtuarit me diçka.”

Idrisit i lindi edhe një pyetje tjetër: -“Cili është burimi i këtij durimi në Kuran?”

-“Ti e di, Idris, -u përgjigj gjyshi, se mënyra për të fituar përkrahjen, dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut është t’i bindesh plotësisht ligjeve dhe urdhrave të Tij që janë shkruar në Kuran. Allahu dëshiron që roberit e Tij të venë në jetë moralin e Kuranit deri në fund të jetës së tyre.

Sekreti që u mundëson atyre t'i binden urdhrave të Tij fshihet në durimin e përsosur që vjen nga besimi. Një njeri që mëson kuptimin e vërtetë të durimit mund të sillet në mënyrën, me të cilën është i kënaqur Allahu dhe është i rregullt në kryerjen e namazit. Një njeri që beson, e di se dituria dhe mençuria e Allahut është kudo, në çdo gjë, asgjë nuk ndodh pa lejen e Tij dhe prapa çdo ngjarje ndodhet qëllimi i saj dhe gjithë ato mirësi të panumërta që Ai ka krijuar."

-“Atëherë, njeriu nuk duhet të mërzitet për ato që i ndodhin, por duhet të ketë durim gjithmonë.” -tha Idrisi.

Gjysh Uthmani tha duke buzëqeshur: -“Është shumë e vërtetë, Idris. Allahu është miku, mbrojtësi dhe përkrahësi i besimtarit. Kështu, të gjitha gjërat që na ndodhin janë në të mirën tonë, edhe pse mund të mos duket kështu me shikim të parë. Për këtë arsye, për një besimtar, të jesh i durueshëm nuk do të thotë të jesh i detyruar të zbatosh një urdhër moral, përkundrazi, ky është një akt adhurimi që kryen ai me gëzim dhe kënaqësi të sinqertë. Besimtarët e dinë se çfarëdo që u ndodh atyre është krijuar nga Allahu dhe prej saj do të vijë vetëm mirësi. Ata përballojnë çdo ngjarje me kënaqësi, sepse e dinë se Allahu ka përcaktuar më të mirën për ta. Në Kuran, Allahu thotë: **“Besimtarë janë ata që janë të durueshëm dhe vetëm Zotit të tyre i mbështeten.”** (Ankebut: 59)

-“Atëherë, besimi i një besimtari nuk mund të vjetrohët! -përfundoi Idrisi i emocionuar. Tani po e kuptoj çfarë po flishte ajo zonja në autobus.”

-“Po, djali im. Njerëzit bëhen të durueshëm, sepse ky është një urdhër nga Allahu dhe kështu ata nuk do të ndodhen asnjëherë në një situatë ku ta humbin durimin. Ata do ta zbatojnë këtë akt adhurimi gjatë gjithë jetës së tyre të etur dhe të kënaqur.”

-“Faleminderit, gjysh. -tha Idrisi. Tani e kuptoj se durimi është shumë i rëndësishëm dhe, nëse dëshiron Allhu, durimi i një besimtari nuk do të vjetrohët.”



KLASA JONË



-“Mirëmëngjes, nxënës, -përshëndeti mësuesi duke hyrë në klasë, të hënën në mëngjes.

-“Mirëmëngjes, mësues.” -ia kthyen nxënësit.

-“Si i kaluat këto ditë pushimi?” -pyeti ai.

-“U kënaqëm shumë mësues. Luajtëm me topa bore dhe bëmë edhe një burrë prej dëbore.”

-“Qënkeni kënaqur me dëborën në fundjavë.” -buzëqeshi ai.

-“Po, mësues, ne ia kaluam shumë mirë.” -u përgjigjën nxënësit.

Mësuesi vështroi rreth e rrotull klasës dhe vrenjti vetullat.

-“Me ç’po shoh, disa nxënës nuk paskan ardhur në klasë sot.”

-“Po, Selimi dhe Aishja mungojnë sot.”

-“A e dini pse?”

-“Kanë qëndruar në shtëpi, mësues. -ia ktheu klasa. Ata duhet të jenë të sëmurë.”

-“Kjo do të thotë se ata kanë luajtur shumë në dëborë.”
-u vrenjt mësuesi.

-“Edhe ne luajtëm në dëborë, mos do të sëmuremi edhe ne mësues?” -e pyeti klasa e alarmuar.





-“Nëse jeni të pakujdesshëm dhe qëndroni në dëborë shumë gjatë, edhe mundet të sëmurëni.”

-“Po, pse i sëmur dëborë njerëzit? Neve na pëlqen shumë kur bie borë dhe kur luajmë me të.”

Mësuesi filloi t’i shpjegonte: -“Arsyeja pse sëmurëni njerëzit është se në trup kanë hyrë viruset. Siç e dini, ato janë organizma të padukshëm. Hyjnë në trupin tonë dhe përpiqen të na dëmtojnë. Nëse nuk jemi të kujdesshëm për higjienën tonë dhe hamë pa larë duart, ato mund të hyjnë në trup dhe qëndrojnë atje.”

-“Po, ne sëmurëmi menjëherë, pasi hyjnë viruset në trup?”
-pyetën nxënësit.


-“Jo. -u përgjigj ai. Jo, mund të mos sëmurëmi gjithmonë.



Allahu na ka krijuar me një sistem imunitar të mrekullueshëm, i cili i lufton viruset. Ne nuk e kuptojmë, por elementët e këtij sistemi imunitar e mbrojnë trupin tonë porsì një ushtri. Çdo ushtar i këtij sistemi kompleks e përmbush detyrën e tij në mënyrë të përsosur."

-“Pse sëmurëmi ne atëherë? Mos ndoshta sistemi ynë imunitar nuk e ka kryer detyrën e tij?”

-“Jo, në një njeri normal, sistemi imunitar është gjithmonë në punë. Edhe pse ne mund të mos jemi të vetëdijshëm, ky sistem angazhohet në një betejë të ashpër me viruset. Në radhë të parë, ai përpiqet që t'i pengojë viruset të hyjnë dhe të qëndrojnë në trupin tonë. Nëse viruset arrijnë të hyjnë brenda në trup, ai i





shkatërron ato menjëherë.”

-“Pse sëmuremi ne atëherë?” -pyetën përsëri nxënësit.

-“Nëse qëndrojmë për shumë kohë në të ftohtë, -shpjegoi ai,- dhe nëse jemi të pakujdesshëm në higjienën e ushqimit, sistemi ynë imunitar dobësohet. Viruset që nuk janë shkatërruar shpërdahen me shpejtësi nëpër trup.”

-“Kur ndodh kjo, gjithë trupin e pushtojnë viruset?” -pyetën nxënësit kureshtarë.

-“Jo. -vazhdoi ai. Në këtë rast sistemi ynë imunitar fillon një luftë edhe më të madhe kundër tyre. Për shkak të kësaj beteje që zhvillohet në trup, ne ndiejmë ethe, nuk jemi si gjithmonë, na dhembin kyçet.”

-“Po. -thanë nxënësit. Kur ndodh kjo, ne qëndrojmë në shtrat.”

-“Sigurisht, kur na ndodh kështu, gjëja më e mirë që mund të bëjmë është të pushojmë. Nëse qëndrojmë në qetësi, marrim ilaçet me orar dhe ushqehemi mirë, sistemi imunitar do të forcohet dhe do të na ndihmojë të shërohem. Kështu, në një kohë të shkurtër, ai do t’i mundë viruset dhe do t’i nxjerrë ato nga trupi. Në këtë mënyrë ne bëhemi të shëndetshëm përsëri.”

-“Tani e kuptuam pse sëmuremi. -i thanë nxënësit. Nga ky moment do të përpiqemi të jemi më të kujdesshëm.”

-“Po, -tha mësuesi: Allahu na ka dhënë një mirësi të madhe me sistemin tonë mbrojtës. Ne duhet ta falënderojmë shumë për të dhe të kujdesemi shumë që ta ruajmë shëndetin që na ka dhënë.”



Shtojcë Mashtrimi i Evolucionit

Në këtë pjesë të librit, ne do të marrim në shqyrtim disa ide të mbrojtura nga evolucionistët, të cilët nuk besojnë në ekzistencën e Allahut dhe përpiqen t'i mashtrojnë të tjerët, duke pretenduar se, gjithçka erdhi në jetë vetë dhe rastësisht. Por, kur dikush përpiqet të mashtrojë dikë tjetër, e vërteta do të dalë një ditë në shesh. Nëse njeriu, i cili mashtrohet është i zgjuar, gjithmonë do të jetë i vetëdijshëm për faktin se është gënjer. Evolucionistët janë kontraktiktorë, për arsye se thonë gënjeshtër. Në faqet në vazhdim do të shohim se, sa të pabaza janë pohimet e tyre dhe se si është zbuluar mashtrimi i tyre.

ÇFARË ËSHTË TEORIA E EVOLUCIONIT?

Teoria e evolucionit është njëra nga idetë e gabuara të parashtruara nga njerëz, të cilët nuk besojnë në ekzistencën e Allahut. Në fillim, kjo ide u propozua nga Çarls Darvini, 150 vjet më parë. Sipas kësaj teorie jologjike, çdo gjë erdhi në ekzistencë spontanisht, në sajë të ndodhjeve të rastit. Për shembull, sipas Darvinit, një ditë të bukur, peshqit u

shndëruan në gjitarë. Një ditë tjetër, ndodhi diçka tjetër e rasti; zvarranikët u shndëruan në zogj dhe filluan të fluturonin. Sa për njerëzit, ata kanë ardhur nga majmunët. Nuk ka absolutisht asnjë të vërtetë në këtë pohim. E vërteta e vetme është se, Allahu na krijoi ne, të gjitha gjallesat e tjera, botën dhe universin. Darvini dhe të tjerët që e kanë ngritur këtë pretendim, kanë thënë një gënjeshtër të madhe.

Atomët janë pjesëzat më të vogla, prej të cilave përbëhet lënda, qoftë e gjallë ose jo e gjallë. Kjo do të thotë se, çdo gjë rreth jush, përfshi edhe veten tuaj, është formuar në sajë të bashkimit të miliona atomeve. Evolucionistët (ata që ndjekin teorinë e Darvinit) thonë se, atomët vendosën të bashkohen dhe kështu, erdhën në jetë gjallesat. Sipas këtij pohim jologjik, një ditë, u ngrit një erë e madhe apo një stuhi dhe u bashkuan të gjitha këto atome. Sipas skenarit të Darvinit, këto atome u bashkuan për të formuar qelizat. Siç e dini, çdo gjallesë përbëhet prej qelizash. Këto qeliza, më pas, bashkohen për të formuar sytë, veshët, gjakun, zemrën, shkurt, gjithë trupin tuaj. Ju duhet të keni parasysh se, qelizat janë sisteme shumë komplekse, apo të ndërlikuara. Në



çdo qelizë, ka shumë organele të ndryshme. Ne mund ta krahasojmë një qelizë me një fabrikë të madhe. Në të ka shumë punëtorë, transportues për materialet, porta për hyrje dhe dalje, qendra prodhimi, transportues mesazhesh, qendra të kontrollit të energjisë, etj. A është e mundur për një fabrikë që të vijë në jetë vetë, rastësisht, pas një stuhie ku, gurët, dheu dhe uji u bashkuan dhe ajo u ndërtua rastësisht? Sigurisht që jo! Çdo njeri do të qeshte me këtë pohim absurd. Megjithatë, evolucionistët, shprehin një pohim që është po kaq qesharak duke thënë se, "Qeliza u formua rastësisht." Ata duan të na bëjnë të besojmë se këto qeliza formuan qeniet e gjalla kur u bashkuan nga një lloj rastësie.

T'i lemë Evolucionistët të Bëjnë një Eksperiment!

T'i lemë të marrin një fuçi të madhe dhe le të hedhin në të çfarë të dëshirojnë. Le të hedhin të gjitha materialet e nevojshme për formimin e një qenie të gjallë.

Më pas, ata mund t'i shtojnë asaj nxehtësi apo elektricitet sa të duan dhe mund ta vëzhgojnë atë për miliona vjet. (Ata mund t'ia lenë këtë detyrë edhe evolucionistëve të rinj, sepse gjithë jeta nuk do t'u mjaftonte për të kryer këtë punë.) Çfarë do të ndodhte pas kësaj? A mendoni se, qershitë, shalqinët, kumbullat, manushaqet, trëndafilat, elefantët, luanët, qingjat, bletët, macet, qentë, ketrat dhe peshqit mund të dilnin nga kjo fuçi? A mund të dilte prej saj një njeri, i cili lumturohet apo emocionohet, të cilit i pëlqen të dëgjojë muzikë dhe të lexojë libra? Sigurisht që jo! Prej saj nuk mund të dilte asnjë njeri, të themi një profesor, i cili të ndiqte zhvillimin e saj. Jo vetëm që s'mund të dilte asnjë profesor, por asnjë qelizë e vetme nga trilonët e qelizave të trupit

të një profesori. Atomet janë të pajeta. A mund të bashkohet lënda e pajetë dhe të prodhojë një qenie të gjallë, që qesh dhe mendon? Sigurisht që jo. Asnjë gjallesë e vetme nuk mund të krijohet prej asaj fuçie, sepse gjallesat nuk përbëhen prej copëzash lënde të pajetë, që formohet rastësisht. Allahu i ka krijuar të gjitha qeniet e gjalla. Ai ka krijuar njerëzit, malet, liqenet, qingjat, luanët dhe lulet, atëherë kur nuk kishte asgjë në ekzistencë. Ai ka krijuar gjithçka nga asgjëja, vetëm duke thënë: "Bëhu!"

Lënda e pajetë kurrë nuk mund të bashkohet për të formuar një krijesë të gjallë. Allahu ka krijuar universin dhe të gjitha gjallesat në të nga asgjëja.



SI KANË EVOLUAR GJALLESAT SIPAS EVOLUCIONISTËVE?

Allahu i ka krijuar të gjitha llojet e gjallesave dhe asnjë prej tyre nuk mund të evoluojë prej tjetrës. Kjo për faktin se, çdo specie ka karakteristikat e saj të veçanta. Teoria e evolucionit është e gabuar në pohimin se saj se, gjallesat kanë evoluar me kalimin e kohës, kanë zhvilluar karakteristika të ndryshme dhe janë shndëruar në gjallesa të tjera. Ju të gjithë i keni parë breshkat, hardhucat dhe gjarprinjtë. Evolucionistët ngrenë pretendimin e palogjikshëm se këta zvarranikë, me kalimin e kohës, u shndëruan në zogj. Po cilat janë këto shkaqe që i bënë zvarranikët të shndërohen në krijesa të tjera? Evolucionistët besojnë se, evolucioni ndodh si rezultat i dy ngjarjeve të veçanta, të cilat ndodhin në të njëjtën kohë, të quajtura “mutacione” dhe “përzgjedhje natyrore.” Ky është në të vërtetë një besim i palogjikshëm dhe pa asnjë bazë shkencore.

Çfarë Është Përzgjedhja Natyrore?

Shpjegimi më i thjeshtë për përzgjedhjen natyrore është se, krijesat që janë më të afta mbijetojnë, ndërsa ato më të dobëtat janë të destinuara të zhduken. Le ta shpjegojmë këtë me anë të një shembulli: mendoni për një tufë drerësh, të cilët sulmohen shpesh nga kafshët e egra. Atëherë, çfarë ndodh? Drerët fillojnë të vrapojnë shpejt, por, vetëm më të shpejtit dhe më të shkathët do të mbijetojnë. Gradualisht, drerët e dobët dhe më të ngathët do të zhduken krejtësisht, për shkak se do t'i sulmojnë grabitqarët. Ndërkaq, do të mbeten vetëm drerët e shëndetshëm dhe të fortë. Prandaj,



Në botë ka me mijëra lloje gjallesash. Evolucionistët kurrë nuk do të jenë në gjendje të shpjegojnë se, si erdhën në jetë ato. Ky është një nga shembujt më të mirë që shfaq mjeshtërinë krijuese të Allahut.

pas pak kohe, tufa do të përbëhet vetëm prej drerësh të aftë. Ajo çfarë kemi thënë deri këtu është e drejtë, por, këto që thamë nuk kanë të bëjnë fare me evolucionin. Megjithatë, evolucionistët besojnë se, kjo tufë drerësh do të zhvillohej gradualisht në një lloj tjetër kafshe, si psh, në gjirafa. Ju vetë mund ta kuptoni se sa të gabuar janë ata në pohimet e tyre! Ju e kuptoni se, sa të gabuar janë ata! Nuk ka rëndësi se sa shpejt vrapon një dre, apo se sa lart e ngre qafën, ai nuk mund të kthehet në një krijesë tjetër, psh në një luan apo gjirafë. Kjo mund të ndodhë vetëm nëpër përralla. Ju ndoshta mund ta dini të gjithë historinë për bretkocën që u shndërrua në princ. Megjithatë, në jetën e vërtetë, për një dre është e pamundur që të kthehet në një luan apo ndonjë kafshë tjetër. Por, megjithatë, evolucionistët ende këmbëngulin se kjo gjë mund të ndodhë!



Ç'janë Mutacionet?

Mutacionet janë ndryshime që sjellin pasoja negative tek një organizëm i gjallë. Ato mund të shkaktohen nga rrezatimet apo nga substancat kimike. Pasojat që lenë pas rrezatimet apo substancat kimike mbi qeniet e gjalla janë gjithmonë të dëmshme. Afrësisht 60 vjet më parë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, një bombë atomike u hodh në qytetin Hiroshima të Japonisë. Ajo shpërndau rrezatim në atë zonë dhe kjo u shkaktoi dëm të madh njerëzve. Rrezatimi i saj shkaktoi sëmundje të rëndë tek shumica e njerëzve që iu ekspozuan atij ose vdekje. E, ç'është me keqja, ajo shkatërroi disa prej sistemeve të tyre në organizëm dhe kjo bëri që fëmijët e tyre të lindnin ose të sëmurë ose të paralizuar, të gjymtuar. Ja pra, kjo është ajo që evolucionistët duan të na bëjnë ne të besojmë: Një ditë të bukur, një peshk i nënshtrohet një procesi mutacioni; psh, ndikohet nga pasojat e rrezatimit, si njerëzit e Hiroshimës, apo nga diçka tjetër të ngjashme. Si rezultat i këtij mutacioni, në trupin e peshkut ndodhin disa ndryshime dhe një ditë ai shndërrohet në krokodil. Ky pohim me të vërtetë na bën për të qeshur. Për më tepër, ashtu siç e përmendëm më lart, mutacionet janë

gjithmonë të dëmshme tek qeniet e gjalla. Ato, ose mund t'i lenë të gjymtuara, ose mund t'i sëmurin gjallesat. Pohimin e evolucionistëve ne mund ta krahasojmë me shembullin më poshtë: nëse do të merrnit një sëpatë dhe ta godisnit fort një televizor bardhë e zi, si thoni, do të kthehej në një televizor me ngjyra? Sigurisht që jo! Nëse, ndonjëherë, do të godisnit një televizor e pakta do të ishte të merrnit në dorë një kafaz për llumbash. Po kështu, do të ndodhte nëse do të godisnit diçka tjetër me sëpatë, pa dyshim që do ta dëmtonte atë. Ashtu, edhe mutacionet i dëmtojnë qeniet e gjalla.



**Ai nuk ka shok në
sundimin e Tij. Ai
krijoi çdo gjë dhe e
përsosi në mënyrë të
qartë e të matur.
(Furkan: 2)**



FOSILET QË EVOLUCIONISTËT NUK PO MUNDEN T'I GJEJNË

Një fosile është një pjesë e një kafshe apo e një bime që ka qenë në tokë për një kohë të gjatë, zakonisht, mijëra apo miliona vjet. Ajo ruhet në formacionet shkëmbore që ndodhen në koren e tokës. Me qëllim që një bimë apo kafshë të kthehet në fosile, ajo duhet që të varroset menjëherë pasi ngordh. Për shembull, nëse në tokë do të ndodhej

një zog dhe mbi të binte një pirg rëre dhe ta vriste, mbetjet e këtij zogu do të ruheshin për miliona vjet.

Ngjashëm me këtë rast, mund të kemi rrëshirën e disa pemëve, të cilat fosilizohen në sajë të proceseve gjeologji-



Nën shtresat e kores së tokës gjenden mbetjet e krijesave që kanë jetuar në të kaluarën. Këto mbetje quhen fosile dhe ato hedhin poshtë teoritë e hedhura prej evolucionistëve.



Kërmill fosil



Merimangë fosile


Allahu krijoi çdo gjallesë prej uji.
Ka prej tyre që zvarriten rrëshqitas në barkun e vet, ka që ecin me dy këmbë, ka edhe të tilla që ecin të me katër këmbët ...

ke dhe në këtë rast quhen "qelibar." Në të kaluarën, kjo rrëshirë kapte zogjtë në grackë, kur rridhte nëpër pemë. Ajo, më pas, u ngurtësua dhe qelibari dhe insektet brenda saj janë ruajtur shumë mirë për miliona vjet me rradhë deri në ditët e sotme. Ky fakt na ndihmon ne të mësojmë shumë për krijesat që kanë jetuar shumë kohë më parë. Të tilla mbetje të ruajtura mirë të një lloji apo të një tjetri quhen fosile.

Ç'kuptojmë me "Forma Kalimtare" të Fosileve?

Gënjeshtra më e madhe që kanë sajuar evolucionistët është ajo e "formave kalimtare". Në disa libra evolucioni ajo mund të gjendet edhe me termin "forma të ndërmjetme kalimtare." Siç e dini, evolucionistët parshetrojnë idenë se, krijesat kanë evoluar nga njëra-tjetra. Ata gjithashtu pohojnë se, krijesa e parë erdhi në jetë në sajë të rastësisë. Ata duan të na bëjnë të besojmë se, me kalimin e kohës, kjo krijesë u shndërrua në një tjetër, e kështu me rradhë. Evolucionistët thonë se peshqit, për shembull, e kanë prejardhjen nga një krijesë që i ngjante yllit të detit. Kjo do të thotë se, një ditë të bukur, në sa-

**... Allahu krijon çka të dojë,
sepse vërtet Allahu ka mundësi
për çdo gjë. (Nur: 45)**



Evolucionistët pretendojnë, për shembull, se, yjet e detit u zhvilluan për miliona vjet dhe u shndërruan në peshq. Sipas këtij pohimi, duhet të ketë shumë “forma të ndërmjetme” që gjenden midis yjeve të detit dhe peshqve. Por, deri tani, nuk është gjetur asnjë formë e tillë e ndërmjetme. Në mbetjet fosile gjenden yje deti dhe peshq, por, nuk ekziston asnjë formë e ndërmjetme me një formë të çuditshme që ngjan me të dy llojet.

jë të mutacionit, ylli i detit e humbi njërin nga krahët e tij. Përgjatë miliona vjetësh në vazhdim, ai i humbi edhe disa nga krahët e tjerë, përveç nja dyve që filluan të bëhen fletëza notimi për hesap të tyre. Po ashtu, në të njëjtën kohë, ndodhën edhe shumë ndryshime që janë të nevojshme që një yll deti të shndërohet në peshk. (Asgjë nga këto që po themi nuk ka ndodhur kurrë, por, ne vetëm sa po ju kujtojmë ju të dashur fëmijë se, me çfarë duan të na mashtrojnë evolucionistët. Sipas teorisë së tyre, yllit të detit iu desh të kalonte nëpër shumë faza, derisa të kthehej në peshk. Kështu, këto krijesa imagjinare, në fazat e tyre të transformimit quhen lloje të ndërmjetme në procesin e evolucionit. Sërisht, sipas teorisë jologjike të evolucionitëve, të gjitha ato duhet të kenë disa pjesë rudimentare apo të paformuara mirë. Për shembull, llojet e ndërmjetme, të cilat, gjatë janë formuar ndërsa peshqit po ktheheshin në zvarranikë, duhet të kenë këmbë, fletëza notimi, mushkëri dhe velëza “gjysmë të zhvilluara”. Ne duhet të kemi parasysh se, nëse në të kaluarën do të kishin jetuar krijesa të tilla, do të gjenim patjetër fosile të tyre. Është interesant fakti se, deri tani nuk është gjetur asnjë fosile e



Qindra fosile peshqish dhe
yesh deti janë gjetur. Por
përkundër trillimeve të
evolucionistëve, asnjë
fosil i ndërmjetëm nuk
është gjetur që të tregojë
një yll deti në procesin e
shndërrimit në peshk.

Një fosil peshku 50 milion vjeçar



Një yll deti fosil 400 milion vjeçar

Yjet e detit nuk kanë ndryshuar kurrë. Ata janë sot ekzaktësisht siç kanë qenë
miliona vjet më parë. Kjo vërteton se evolucionistët kanë gënjyer. Sipër mund të
shihni një yll deti dhe përkrah një yll deti fosil 400 milion vjeçar.



Foto e një gaforeje fosile që ka
jetuar 150 milion vjet më parë



Foto e një gaforeje që jeton në ditët
e sotme. Nuk ka asnjë
ndryshim midis dy gaforeve, apo jo?

këtyre llojeve të ndërmjetme, për të cilët evolucionistët pretendojnë të kenë ekzistuar. Krijesat nuk kanë ardhur nga njëra-tjetra. E vërteta është se, ato u sollën në jetë menjëherë, me të gjitha karakteristikat e tyre të paprekura dhe pa të meta. Ata nuk ndryshojnë aspak nga anëtarët e tjerë të llojeve të ndryshme, të cilat janë të gjalla në ditët e sotme. Allahu i krijoi ato të gjitha, pa përjashtim.

ÇFARË NDODHI GJATË PERIUDHËS KEMBRIANE?

Fosilet më të vjetra, janë ato, të cilat datojnë që nga koha e njohur si era Kembriane, që do të thotë 500 milion vjet më parë. Krijesat që kanë jetuar gjatë kësaj ere provojnë gjithashtu se, teoria e evolucionit është tërësisht një marrëzi. Po në ç'mënyrë?

Këto krijesa janë shfaqur të gjitha njëherësh gjatë erës Kembriane. Para tyre nuk kishte asnjë gjallesë në planet. Fakti që, këto krijesa u shfaqën prej asgjësë dhe përnjëherë, është një provë që vërteton se, Allahu i krijoi ato në një moment të vetëm. Nëse teoria e propozuar nga evolucionistët do të ishte e vërtetë, atëherë, këto krijesa do të kishin evoluuar gradualisht prej paraardhësve të tyre më të thjeshtë. Por, megjithatë, këto krijesa nuk kanë as paraardhës, as formë të kalimtare që të kenë jetuar para tyre. Nuk ka absolutisht asnjë gjurmë organizmash të tillë askund në mbetjet fosile. Fosilet na tregojnë se, këto krijesa, ashtu si dhe të gjithë gjallesat e tjera, u shfaqën papritur gjatë erës Kembriane, me të gjitha cilësitë e tyre të paprekura, por, pa asnjë paraardhës të supozuar evolutiv, prej të cilit të kishin



Kjo krijesë e quajtur “trilobite” ka jetuar në erën Kambriane

evoluar. Kjo është prova më e qartë se, Allahu është Krijuesi i tyre. Për shembull, gjatë erës Kambriane ka jetuar një krijesë e quajtur trilobite, ndonëse ne nuk mund t'i shohim ato tani, sepse janë zhdukur. Trilobitet kishin sy shumë të ndërlikuar dhe të përsosur. Atë përbëheshin prej qindra qelizash në formë hojesh dhe këto qeliza u mundësonin atyre që të shihnin në mënyrë të përkryer. Është e qartë se, gjallesa me të tilla karakteristika të mrekullueshme nuk ka mundësi që të kenë ardhur në jetë në sajë të rastësisë.

GËNJESHTRA SE PESHQIT JANË SHNDËRUAR NË ZVARRANIKË

Evolucionistët thonë se, zvarranikët e kanë prejardhjen nga peshqit. Sipas tyre, një ditë, kur ushqimi në det u pakësua mjaft, peshqit vendosën ta kërkonin atë në tokë dhe kur mbërritën atje, ata u shndëruan në zvarranikë me qëllim që të



Shpikje e Imagjinatës

mbijetonin. Siç mund ta shihni, kjo është një ide absurde, sepse gjithkush e di se çfarë do të ndodhte nëse peshqit do të mbeteshin pa ujë: ata do të ngordhnin! Keni shkuar ndonjëherë për peshk? Vetëm mendoni! Çfarë do të ndodhte nëse peshkut do t'i ngecte karremi dhe do të varej në kallamin tuaj dhe ju do t'i shpëtonit jetën dhe do ta çonit në shtëpi për të pushuar në oborrin tuaj? Ashtu siç thamë edhe më parë, sigurisht që do të ngordhte. Nëse do të shkonit përsëri për peshk dhe do të kapnit mjaft dhe t'i çonit përsëri në shtëpi, çfarë do të ndodhte? Po e njëjta gjë: ata të gjithë do të ngordhnin! Me gjithatë, evolucionistët refuzojnë të pajtohen me këtë fakt. Ata thonë se, një nga peshqit në oborrin tuaj, papritur filloi të ndryshojë kur ishte duke ngordhur dhe u shndërrua në zvarranik dhe vazhdoi të jetonte! Kjo është plotësisht e pamundur! Kurrë nuk mund të jetë e mundur, sepse midis peshqve dhe krijesave të tokës ka shumë ndryshime dhe të gjitha ato nuk mund të ndodhin papritur dhe rastësisht. Le të përmendim disa elementë që u nevojiten peshqve për të mbijetuar në tokë:

1. Peshqit përdorin velëzat për të marrë frymë në ujë. Në tokë ata nuk mund të marrin frymë me velëza dhe kështu do të ngordhin nëse do të mbeten pa ujë. Atyre u duhen mushkëri-

të. Le të supozojmë se, një peshku iu mbush mendja të linte ujin dhe të jetonte në tokë: ku do t'i gjente mushkëritë? Për më tepër, ai nuk e ka idenë se ç'janë mushkëritë!

2. Peshqit nuk kanë një sistem veshkash si i yni, por, nëse do t'ju duhej të jetonin në tokë do të kishin nevojë për një të tillë. Nëse do të vendosnin të lëviznin në tokë të thatë, është shumë e qartë se, një peshk nuk do të ishte i aftë të gjente diku ndonjë palë veshka për vete.

3. Peshqit nuk kanë këmbë, prandaj nuk mund të ecin kur mbërrijnë në breg. Po si ia bënë peshqit të gjenin këmbë, kur vendosën të dilnin në tokë të thatë? E gjitha kjo është qartas e pamundur. Janë vetëm nja treqind gjëra që duhet të kishin patur peshqit, me qëllim që të mbijetonin në tokë.

Po Peshku Me Emrin Koelakanth?

Për vite me rradhë, evolucionistët, një peshk me emrin koelakanth, e kanë quajtur si formë kalimtare, e cila pothuajse kishte dalë në breg të detit. Në të gjithë librat dhe revistat e tyre, ata e portretizonin atë si një provë të teorisë së tyre. Ata mendonin se, koelakanthi kishte shumë kohë që ishte zhdukur. Kjo është arsyeja pse shpikën një seri histo-



Evolucionistët pretendojnë se, koelekanthi është një peshk që filloi të shdërrohej në një zvarranik. Më vonë, u zbulua një koelekanth i gjallë, duke dalë në shesh marifeti i evolucionistëve. Koelekanthi është një peshk i vërtetë.


rish false kur studiuar fosilet e këtij peshku. Vetmë pak vjet më vonë, një peshkatar kapri një koelakanth të gjallë. Qysh atëherë, janë kapur shumë të tjerë. U bë e qartë se, koelakanthi është një peshk normal. Për më tepër, sipas evolucionistëve nuk ishte përgatitur për të dalë në breg. Evolucionistët janë shprehur se: "Ai jetonte në ujë shumë të cekët dhe po bëhej gati të dilte në breg." Në të vërtetë, koelakanthi jetonte në ujë shumë të thellë. Ai nuk ishte një formë kalimtare siç donin të besonin evolucionistët, por ishte një peshk i vërtetë. Që atëherë, deri në ditët e sotme, janë zbuluar mjaft ide fallco të evolucionistëve.

POHIMI SE, ZOGJTË E KANË PREJARDHJEN NGA ZVARRANIKËT ËSHTË I GËNJESHTËRT

Një deklaratë tjetër të gënjeshtërt që bëjnë evolucionistët është në lidhje me faktin se, si erdhën në jetë zogjtë. Përralla e tyre e gjatë thotë se, zvarranikët, të cilët jetonin nëpër pemë, filluan të kërcenin nga njëra pemë tek tjetra



dhe, në këtë kohë, ata zhvilluan krahët. Madje, një përrallë tjetër është se, disa zvarranikë, duke u përpjekur të kapin miza, filluan të vraponin dhe të përplasnin parakrahët dhe se, këta, më vonë, u shndërruan në krahë. A nuk është absurde të imagjinosh një dinosaur të zhvillojë krahë duke vrapuar? Gjëra të tilla mund të ndodhin vetëm nëpër përralla apo filma vizatimorë. Ka edhe një çështje shumë të rëndësishme. Këta evolucionistë thonë se, ky dinosaur i madh zhvilloi krahë kur përpiqej të kapte miza. Mirë, po si ia bënte vetë miza për t'u ngritur në ajër? Ku i gjeti krahët? Kur ata përpiqeshin të shpjegonin se, si mund të fluturonte një dinosaur i madh, a nuk duhet të kshin shpjeguar më parë se si mundej të fluturonte një insekt i vogël? Sigurisht që po. Por, kjo është një nga çështjet që evolucionistët nuk do të jenë kurrë në gjendje ta shpjegojnë. Miza është një nga krije-



sat më të mira fluturuese në tokë. Ajo mund t'i përplasë krahët nga 500–1000 herë në sekondë. Siç e dini, ajo mund të manovrojë në ajër me lehtësi të madhe. Nuk ka rëndësi se, sa përralla tregojnë evolucionistët, ata ende nuk mund të shpjegojnë se, si u krijuan krahët e zogjve. E vërteta është se: Allahu ka krijuar krahët e zogjve dhe të mizave, së bashku me aftësinë e tyre për të fluturuar.

Arkeopteriksi, Të Cilin Evolucionistët e Quajnë Formë të Ndërmjetme, Ishte në të Vërtetë Një Zoq Plot Me Pupa!

Në fillim le të japim disa ndryshime midis zvarranikëve dhe zogjve:

1. Zogjtë kanë krahë, kurse zvarranikët jo.
2. Zogjtë kanë pendë, kurse zvarranikët luspa.
3. Zogjtë kanë një sistem skeleti unik dhe kockat e tyre janë të zgavëruara. Kjo bën që ata të jenë më të lehtë dhe ua lehtëson fluturimin. Këto janë vetëm disa ndryshime, të cilat të vijjnë ndër mend menjëherë. Por, ka edhe mjaft ndryshime të tjera midis këtyre krjesave. Nëse ndonjë lloj zvarranikësh do të ishte shndërruar në zogj, duhet të kishte patur shumë krijesa që duhet të kishin jetuar midis zogjve dhe zvarranikëve, të cilat të përfaqësonin fazat e këtij ndryshimi. Studiuesit e fosileve duhet të kenë ndeshur të paktën një nga këto lloje fosilesh. Kjo do të thotë se, duhet të kenë ekzistuar krijesa me gjysmë krahë, gjysmë të veshur me pupla dhe gjysëm me luspa, gjysmë gojë e gjysmë sqep dhe fosilet e tyre duhet të jenë gjetur, por, e vërteta është se, asnjë shëmbëllturyrë e tillë nuk është hasur në fosilet e tokës.

Fosilja e një zogu të quajtur Arkeopteriks, të cilën evolucionistët u përpoqën ta përkruanin si një lloj të ndërmjetëm, tregon se evolucioni është një teori që mbështetet mbi mashtrimin. Kjo fosile i përket një zogu të vërtetë dhe tregon se zogjtë nuk kanë ndryshuar aspak për miliona vjet.



Ato fosile që janë gjetur i përkasin ose një zvarraniku të plotë, ose një zogu të plotë. Kjo do të thotë se, zogjtë nuk kanë evoluar prej zvarranikëve. Është Allahu, Ai, i cili ka krijuar zogjtë, ashtu si dhe gjithë gjallesat e tjera. Megjithatë, meqenëse, evolucionistët nuk duan ta pranojnë këtë, atëherë përpiqen t'i bindin edhe njerëzit e tjerë se, ajo që thonë ata është e vërtetë, duke shpikur përralla. Ata kanë gjetur fosilen e një zogu, të quajtur Arkeopteriks, i cili ka jetuar 150 milion vjet më parë dhe pretendojnë se, ky zog është një formë kalimtare midis dinosaurve dhe zogjve. Por, të thuash se, Arkeopteriksi ishte një paraardhës i zogjve është krejtësisht jologjike, sepse, ai ishte një zog me trupin të mbuluar me pupla! Për arsyen se:

1. Ai kishte pupla, ashtu si zogjtë në kohën tonë.
2. Ai kishte të njëtin kafaz kraharori, në të cilin ishin kapur krahët, ashtu si dhe zogjtë e tjerë që fluturojnë.
3. Arkeopteriksi nuk mund të jetë paraardhësi i të gjithë llojeve të zogjve sepse, janë gjetur fosile zogjsh që janë më të vjetër se ai.

PËRRALLA E GJATË E EVOLUCIONIT TË NJERIUT

Evolucionistët mbrojnë pikëpamjen se, njerëzit e kanë prejardhjen nga majmuni dhe për këtë arsye, majmunët janë paraardhësit tanë. As Darvini, as ndonjë evolucionist tjetër, nuk kanë patur kurrë ndonjë provë për ta mbështetur këtë pikëpamje, e cila është krejtësisht një fabrikim. Në të vërtetë, një nga arsyet pse u mendua teoria e evolucionit, në rradhë të parë, është t'i bëjë njerëzit të harrojnë se, janë krijesa të Allahut. Nëse njerëzit besojnë se, ata kanë ardhur në jetë rastësisht dhe paraardhësit e tyre janë majmunët, atëhe-

Allahu krijoi qeniet njerëzore me gjuhë, raca dhe ngjyra të ndryshme. Kjo shumëllojshmëri është një mirësi e mrekullueshme.



rë ata nuk do të ndejnë asnjë lloj përgjegjësie kundrejt Allahut. Si rrjedhim, kjo do t'i bënte ata të harronin të gjitha vlerat fetare dhe të bëheshin tepër egoistë. Vetëm njerëzit egoistë i humbin vlera të tilla, ashtu siç është dashuria për njerëzit dhe familjet e tyre. E kuptoni se, evolucionistët përpiqen t'i largojnë njerëzit prej ndjenjave të tilla dhe kjo është arsyeja pse, ata përpiqen të përhapin teorinë e evolucionit. Qëllimi i tyre është t'i bëjnë njerëzit ta harrojnë Allahun dhe i drejtohen çdo njeriu duke i thënë: "Allahu nuk të krijoi ty. Ti ke erdhur nga majmuni, me fjalë të tjera, ti je një kafshë e përparuar." E vërteta është se, Allahu i ka krijuar të gjithë njerëzit. Krahasuar me të gjitha kafshët e tjera, njeriu është krijesa e vetme që mund të flasë, të mendojë, të



ngazëllehet, të marrë vendime, është inteligjent, mund të themelojë qytetërimi dhe mund të komunikojë në një nivel shumë të përparuar. Allahu është Ai, i Cili ua ka dhënë të gjitha këto cilësi qenieve njerëzore.

Evolucionistët Nuk Mund të Ofrojnë Asnjë Provë se Njerëzit e Kanë Prejardhjen nga Majmuni

Në fushën e shkencës, është shumë e rëndësishme sjellja e “prova-ve”, apo argumenteve. Kur nxjerr një teori dhe dëshiron që edhe të tjerët ta besojnë atë, atëherë, duhet të japësh prova që e vërtetojnë atë. Për shembull, nëse në rastin më të thjeshtë, ju i prezantoheni dikujt dhe ai nuk beson se ju jeni ai që jeni, atëherë në këtë rast, duhet të keni ndonjë provë që t’ia vërtetoni. Cila do të ishte prova ju-aj? Një provë do të ishte psh, një kartë identiteti, një çertifikatë lindje, pasaporta ose ndonjë dokument tjetër. Nëse do t’ia tregonit këto,

këtij njeriu do t'i mbushej mendja se, ju jeni ai që jeni. Tani le të japim një shembull shkencor. Ishte një shkencëtar, i quajtur Isak Njuton, i cili ka jetuar në shekullin e 18-të, i cili thuhet se, ka zbuluar gravitetin. Kur njerëzit e pyesnin se, çfarë e bëri atë kaq të sigurt, ai përgjigjej:

“Kur molla shkëputet nga pema, ajo bie në tokë, nuk qëndron në ajër.” Kjo përgjigje desh të thoshte se,

ekziston një forcë që e tërheq mollën të bierë në tokë, të cilën ai e quajti “gravitet.” Ngjashëm me këtë rast, edhe evolucionistët duhet të shfaqin disa prova për t'i bërë të besueshme teoritë e tyre. Për shembull, teoria e evolucionit thotë se, njeriu ka ardhur nga majmuni. Për këtë arsye, ne duhet t'i pyesim ata: Ku e gjetët këtë ide dhe ku janë provat tuaja? Nëse majmunët do të ishin me të vërtetë paraardhësit e njeriut, ne duhet të gjenim patjetër fosile të krijesave që do të ishin gjysmë majmun, gjysmë njeri, si vërtetim të kësaj. Megjithatë, nuk është zbuluar ende ndonjë fosile e tillë. Ne kemi gjetur vetëm fosilet e njerëzve ose të majmunëve. Kjo do të thotë se, evolucionistët nuk kanë absolutisht asnjë provë që majmunët janë paraardhësit e njeriut. Megjithatë, ata ende përpiqen t'i devijojnë njerëzit me teoritë e tyre.



Disa Mashtrime të Evolucionistëve:

1. Evolucionistët flasin për fosilet e majmunëve të zhdukur sikur ato t'u përkisnin krijesave që, sipas tyre, ishin gjysmë majmun e gjysmë njeri. Ju, sigurisht që, duhet të kenë parë diku foto si kjo më lart, apo jo? Evolucionistët i përdorin ato për të mashtruar njerëzit. E vërteta është se, krijesa të tilla nuk kanë ekzistuar kurrë. Në të kaluarën, kanë ekzistuar njerëz si dhe majmunë, ashtu si në ditët e sotme dhe ata kanë qenë dhe janë krejtësisht të ndarë njëri nga tjetri dhe nuk kanë asnjë lidhje me njëri-tjetrin. Asnjë nga krijesat e shfaqura në faqen e kaluar nuk ka ekzistuar kurrë. Kjo gjë nuk ka ndodhur kurrë. Ashtu siç thamë edhe më lart, nuk është gjetur asnjë fosile që ta provojë një pohim të tillë. Megjithatë, evolucionistët vazhdimisht provojnë gënjeshtra të tipit të fundit mbi këtë temë. Për shembull, kur ata studiojnë një fosile që i përket një lloji të zhdukur majmunësh, ata pretendojnë se, ajo i përkiste një krijese midis majmunit dhe njeriut. Meqenëse, njerëzit nuk janë të mirëinformuar mbi këtë temë, ata priren të besojnë ato që thonë evolucionistët.

2. Evolucionistët i trajtojnë fosilet e njerëzve që u përkasin racave të ndryshme sikur ato të ishin krijesa gjysmë majmun, gjysmë njeri. Siç e dimë, në botë, ka mjaft raca etnike, si: Afrikanët, Kinezët, Amerikanët Indigjenë, Turqit, Europianët, Arabët e shumë të tjerë. Është e qartë se, njerëzit që i përkasin grupeve të ndryshme etnike kanë karakteristika të ndryshme. Për shembull, Kinezët kanë sy në formë bajame dhe disa Afrikanë kanë lëkurë me ngjyrë shumë të errët dhe flokë shumë të dredhur. Kur shihni një Amerikan Indigjen dhe një Eskimez, menjëherë, ju e kuptoni se, ata i përkasin grupeve të ndryshme etnike. Në të kaluarën, kanë ekzistuar shumë grupe të tjera etnike dhe disa nga karaktere-

ristikat e tyre ishin të ndryshme nga ato që kanë njerëzit sot. Për shembull, kafkat e njerëzve që i përkisnin racës së Neandertalit ishin më të mëdha se kafkat e njerëzve që jetojnë sot. Gjithashtu, muskujt e tyre ishin më të fortë se tanët. Megjithatë, evolucionistët i shfrytëzojnë ndryshimet midis kësaj race dhe tonës si një mënyrë për të mashtruar njerëzit. Për shembull, kur gjejnë një kafkë që i përket racës së Neandertalit ata thonë: "Kjo kafkë i përket paraardhësve të njeriut, të cilët kanë jetuar dhjetra mijëra vjet më parë." Ndonjëherë kafkat që ata gjejnë janë më të vogla se masa mesatare e kafkës së njerëzve që janë sot. Duke treguar me gisht tek ajo, ata thonë: "Ai që e ka patur këtë kafkë ka qenë pika e kalimit nga majmuni tek njeriu." Në realitet, edhe sot ka njerëz që i përkasin racave të ndryshme etnike, të cilët kanë kafka më të vogla se mesatarja. Për shembull, vëllimi i kafkës së Australianëve Autoktonë (Aborigjenëve) është shumë e vogël, por kjo nuk do të thotë se, ata janë gjysmë majmunë, gjysmë njerëz. Ata janë njerëz normalë, njëlloj si ju dhe si gjithkush tjetër. Rrjedhimisht, ne mund ta shohim se, fosilet të cilat, evolucionistët i portretizojnë si provë që tregojnë se njerëzit kanë rrjedhur nga majmuni, u përkasin racave të mëhershme të majmunëve apo njerëzve, të cilët tashmë janë zhdukur. Kjo do të thotë se, krijesat gjysmë majmun, gjysmë njeri nuk kanë ekzistuar kurrë.

DALLIMI MË I MADH


Dallimi më i madh midis majmunëve dhe njerëzve është se, njerëzit kanë shpirt, kurse majmunët jo. Njerëzit kanë ndërgjegji: ata mendojnë, flasin dhe i përçojnë mendi-

met e tyre të tjerëve në fjali të kuptimshme, marrin vendime, ndiejnë, zhvillojnë shije, dinë për artin, pikturojnë, kompozojnë, këndojnë dhe janë të mbushur plot ndjenja dashurie dhe vlera morale. Të gjitha këto cilësi janë unike për shpirtin e njeriut. Vetëm qeniet njerëzore i posedojnë këto karakteristika të veçanta. Evolucionistët janë të paaftë t'i përgjigjen kësaj pyetje. Një majmun, që t'i ngjante një njeriu, duhet t'i nënshtrohej shumë ndryshimeve fizike dhe duhej të kishte cilësi të tjera të njëjta me njerëzit. A ka ndonjë forcë në natyrë që t'ia japë një majmuni aftësi të tilla si: të menduarit, apo artet, si piktura dhe kompozimi? Sigurisht që jo! Allahu i ka krijuar vetëm njerëzit me të tilla aftësi dhe nuk u ka dhënë kafshëve asnjë nga këto aftësi. Siç e pamë, për një majmun është krejtësisht e pamundur që të shndërrohet në një qenie njerëzore. Qeniet njerëzore kanë qenë të tilla qysh nga dita kur u krijuan. Po ashtu, peshqit kanë qenë peshq dhe zogjtë kanë qenë zogj. Asnjë krijesë nuk është paraardhës i ndonjë tjetri. Allahu është Krijuesi i të gjithë njerëzve dhe i të gjitha gjallesave të tjera. Arsyeja pse, evolucionistët pretendojnë se, njeriu ka ardhur nga majmuni, është ngjashmëria fizike midis tyre. Megjithatë, ka edhe krijesa të tjera që u ngjajnë njerëzve edhe më tepër. Për shembull, papagalli që shihni në figurë mund të flasë. Oktapodët kanë sy të ngjashëm me ata të njerëzve. Macet dhe qentë na binden dhe dëgjojnë urdhrat tona krejt si njerëzit. Ç'do të mendonit nëse dikush do t'ju thoshte se, njerëzit kanë ardhur nga qentë, papagajtë apo oktapodët? E kuptoni, nuk ka ndryshim midis idesë dhe historive që shpikin evolucionistët.



**ALLAHU
ËSHTË
KRIJUESI I
GJITHÇKAJE**

Zoti Ynë është Ai që ka vendosur biliona copëza informacioni në një vend kaq të vogël sa që, ne nuk mund ta shohim pa përdorur pajisje speciale. Allahu është Ai që na ka krijuar ne, sytë tanë, flokët, këmbët tona. Ai është, gjithashtu, Krijuesi i familjeve tona, i prindërve tanë, vëllezërve dhe motrave, shokëve dhe mësuesve. Allahu është Ai, që ka krijuar për ne ushqimin, të cilin ne e duam aq shumë, reçelin, drithërat dhe brumërat, frutat dhe perimet, që na bëjnë ne të shëndetshëm dhe të fortë. Nëse Allahu nuk do ta kishte krijuar luleshtrydhen, ne nuk do ta dinim se, si do të ishte shija e saj. Allahu na ka dhënë gjithashtu shqisat e të shijuarit dhe të nuhatjes. Nëse Ai nuk do të na i kishte dhënë ato, ne nuk do të dinim se çfarë shije do të kishin ushqimet. Për ne do të ishte njëloj të hanim një patate apo një tortë. Allahu



nuk ka krijuar vetëm ushqime të shijshme dhe me aromë të këndshme, por, Ai na ka dhënë neve aftësitë e nevojshme për t'i shijuar ato. Ju pëlqeni disa gjëra dhe kënaqeni me to dhe mendoni sa të këndshme janë. Për shembull një ëmbëlsirë, një lojë me të cilën kënaqeni duke luajtur apo një shëtitje me njerëzit e afërt. Çfarëdo që të jetë, kurrë mos harroni se, është Allahu Ai i Cili i mundëson për ju të gjitha këto. Sepse Ai është Krijues i Gjithmëshirshëm dhe Ai iu fal juve gjithmonë dhuratat të bukura dhe të këndshme. Ka qenë një kohë kur ju nuk ekzistonit. Vetëm mendoni pak, ju nuk ishit askund para se të krijoheshit. Ju ishit asgjë. Allahu iu krijoi juve nga asgjëja. Për këtë arsye, ne duhet t'i jemi mirënjohës Allahut për çdo moment të jetës tonë. Në çdo gjë me të cilën kënaqemi dhe e duam, ne duhet të përkujtojmë Allahun dhe të themi: "O Allah! Unë të falenderoj Ty për të gjitha mirësitë që më ke falur." E nëse e gjejmë veten në një situatë të pakëndshme, përsëri duhet t'i lutemi Atij, sepse, vetëm Ai mund t'i rregullojë punët dhe gjendjet tona. Ai na i dëgjon lutjet dhe u përgjigjet atyre. Allahu e di se, çfarë mendojmë ne në thellësi të zemrave tona; Ai dëgjon dhe i përgjigjet çdo lutje. Ajo që na mbetet të bëjmë është, ta falenderojmë me gëzim Zotin tonë, i Cili na krijoi neve, botën tonë me gjithë mirësitë që përmban ajo. Duke ditur se, Allahu është gjithmonë me ne, na shikon dhe na dëgjon në çdo moment, ne duhet të vishemi gjithmonë me një sjellje të hijshme.

***Ëngjëjt thanë: "Lavdia të doftë Ty
Zoti ynë. Ne nuk kemi dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Ti je i
Gjithëdijsmi, i Urti."
(Bekare:32)***

Gjithashtu nga Harun Jahja

Libra për Fëmijë





<http://www.harunyahya.com/albanian>